

FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS  
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA

---



STATUTI I FEDERATËS SË FUTBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 27 Janar 2023;

Përmbajtja	Faqe
PËRKUFIZIMET	3
I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME 1-11	5
II. ANËTARËSIMI 12-23	10
III. PRESIDENT NDERI DHE ANËTAR NDERI 24	17
IV. ORGANIZIMI 25-58 A. Kuvendi B. Komiteti Ekzekutiv C. Presidenti D. Sekretariti i përgjithshëm E. Komisionet e përhershme F. Organet e licencimit të klubeve	18
V. KOMISIONET E PAVARURA 59-65	37
VI. MASAT DISCIPLINORE 66	40
VII. ARBITRAZHI 67-68	41
VIII. FINANCAT 69-76	42
IX. GARAT DHE TË DREJTAT NË GARA DHE NGJARJE 77-80	44
X. NDESHJET DHE GARAT NDËRKOMBËTARE 81-83	46

## PËRKUFIZIMET

Termet e dhënë më poshtë tregojnë si vijon:

**FFK:** Federata e Futbollit e Kosovës; Football Federation of Kosovo (angl)

**UEFA:** Union of European Football Associations

**FIFA:** Fédération Internationale de Football Association.

**Federata:** një shoqatë futbollit e njohur si e tillë nga FIFA dhe nga konfederatat përkatëse. Ajo është anëtare e FIFA-së, përveç nëse një kuptim ndryshe është i dukshëm nga konteksti.

**Futbolli:** loja/gara e kontrolluar dhe organizuar nga FIFA, konfederatat dhe/ose FFK në përputhje me Ligjet e Lojës.

**Ligjet e Lojës:** ligjet e Federatës së Futbollit të nxjerra nga IFAB në përputhje me dispozitat përkatëse të statuteve të FIFA-së.

**Ligë:** një organizim i cili i nënshtrohet një federate.

**Lidhja Rajonale e Futbollit (LRF):** organizim apo organ i Federatës së Futbollit të Kosovës, e cila i nënshtrohet FFK-së.

**Konfederatë:** grup shoqatash të njohura nga FIFA që i përkasin të njëjtit kontinent (ose rajon gjeografik të asimilueshëm).

**Klub:** një anëtar i një shoqate (që është anëtar i FIFA-së dhe i konfederatës përkatëse) ose një anëtar i një lige të njohur nga një shoqatë në të cilën të paktën një ekip merr pjesë në një garë.

**Klub i FFK:** Anëtar i FFK-së ose anëtar i ndonjë lige të njohur nga FFK që ka të paktën një garë të organizuar nga FFK.

**Zyrtar:** çdo anëtar bordi (përfshirë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv), anëtar i komitetit, gjyqtar dhe ndihmës gjyqtar, trajner, trajner dhe çdo person tjetër përgjegjës për çështjet teknike, mjekësore dhe administrative (stafi i FFK-se) në FFK, UEFA dhe FIFA, konfederatë, shoqatë, ligë ose klub, çdo person i angazhuar për ofrimin e shërbimeve në FFK, si dhe çdo person tjetër që është i detyruar të respektojë statutet e FFK-së, UEFA-së, FIFA-së (përveç lojtarëve dhe agentëve).

**Lojtar:** lojtar futbollit i licencuar nga FFK.

**Kuvendi:** organi më i lartë dhe legjislativ i FFK-së

**Komiteti Ekzekutiv:** organ strategjik, vendimmarrës dhe mbikëqyrës i FFK-së.

**Anëtar:** person juridik i pranuar në anëtarësi të FFK-së.

**Anëtarë të drejtpërdrejtë:** Lidhjet Rajonale të Futbollit, Shoqatat Profesionale të Futbollit dhe Klubet që marrin pjesë në Kampionatin e Super Ligës dhe në Kampionatin e Ligës së Parë janë anëtarë të drejtpërdrejtë të FFK-së. Lista e anëtarëve të drejtpërdrejtë është e shfaqur në Nenin 13, paragrafin 2.

**Anëtarë jo të drejtpërdrejtë:** Të gjitha Klubet tjera që nuk janë anëtarë të drejtpërdrejtë të FFK-së (d.m.th. të lidhur me një Lidhje Rajonale të Futbollit).

**Delegat:** person fizik i cili në mënyrë të vlefshme përfaqëson një Anëtar me anëtarësi të drejtpërdrejtë në Kuvend.

**Shoqatë futbollit:** lojë e kontrolluar nga FIFA dhe e organizuar nga FIFA, konfederatat dhe/ose shoqatat në përputhje me Rregullat e Lojës.

**Rregullat e lojës:** rregullat e Federatës së futbollit të nxjerra nga IFAB në përputhje me dispozitat përkatëse të Statuteve të FIFA-së.

**IFAB:** Bordi i Shoqatës Ndërkombëtare të Futbollit (BSHNF).

**Gjykatat e zakonshme:** gjykatat shtetërore të cilat shqyrtojnë mosmarrëveshjet juridike publike dhe private.

**Tribunali i arbitrazhit:** gjykatë private e drejtësisë e pavarur dhe e krijuar në mënyrë të rregullt, që vepron në vend të një gjykate të zakonshme.

**CAS:** Gjykata e Arbitrazhit Sportiv me seli në Lozanë (Zvicër).

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### PREAMBULA

Federata e Futbollit të Kosovës është themeluar më 19 gusht 1991 dhe është anëtare e Fédération Internationale de Football Association (FIFA) që nga viti 2016 dhe e Unionit të Shoqatave Evropiane të Futbollit (UEFA) që nga viti 2016. Federata e Futbollit të Kosovës është anëtare e Komiteti Olimpik të Kosovës dhe i vetmi subjekt kompetent për organizimin e futbollit në territorin e Republikës së Kosovës.

Në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Anëtarësimit në Organizatat Joqeveritare, Kapitullit VI të Ligjit nr. 2003/24 të Sportit, Ligjit nr.04/L-075 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport, Ligji nr.06/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-075, Udhëzimin Administrativ nr.03/2015 për Themelimin dhe Regjistrimin e klubeve publike dhe private të sportit, Udhëzimit Administrativ nr.01/22 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Themelimit, Licencimit dhe Ri-vlerësimit të Federatave dhe Organizatave Sportive, dhe vullnetit të lirë të delegatëve të Kuvendit të Federatës së Futbollit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 27/01/2023, miratoi këtë:

---

### Neni 1 Forma ligjore, selia dhe shenjat tregtare

---

1. Federata e Futbollit të Kosovës është organizatë joqeveritare (OJQ) me karakter shoqatë, e krijuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Formohet për një periudhë të pacaktuar.
2. Selia e FFK-së ndodhet në Prishtinë, Kosovë, adresa: rruga “28 Nëntori”, nr. 171.
3. FFK është anëtare e FIFA-së dhe i UEFA-së.
4. Flamuri i FFK ka ngjyrë të kaltër dhe në mes përmban emblemen e FFK-së.
5. Stema e FFK-së përbëhet nga vizatimi i një mburoje, bazuar në mburojën nga flamuri Dardan, gjashtë (6) yje të bardhë, një vizatim të një topi të futbollit dhe një vizatim të diellit Dardan. Simboli i diellit paraqitet si pjesa e artë e mburojës qendrore, e ndjekur nga një top i bardhë i futbollit. Stema e FFK-së përdoret në ngjyrë të kaltër, të zezë, të bardhë dhe ngjyrë ari.
6. Shkurtesa e Federatës së Futbollit të Kosovës është FFK.
7. Flamuri, emblema, stema dhe shkurtesa ligjërisht regjistrohen në organet përkatëse shtetërore të Kosovës, dhe organet ndërkombëtare për mbrojtjen e pronës intelektuale.

8. FFK është e vetmja organizatë kompetente e autorizuar nga institucioni i Kosovës, që organizon, udhëheqë dhe rregullon garat e futbollit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

---

## Neni 2 Objektivat

---

Objektivat e FFK-së, janë:

- a) të përmirësojë vazhdimisht lojën e futbollit dhe ta promovojë, rregullojë dhe kontrollojë atë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, nën dritën e lojës së ndershme dhe vlerave të saj unifikuese, edukuese, kulturore dhe humanitare, veçanërisht përmes programeve të të rinjve dhe zhvillimit;
- b) të organizojë gara në futboll shoqatash, futsal dhe të tjera në nivel të territorit shtetëror të Kosovës, duke përcaktuar saktësisht, sipas nevojës, fushat e autoritetit që u jepen ligave të ndryshme nga të cilat përbëhet;
- c) të hartojë rregullore dhe dispozita dhe të sigurojë zbatimin e tyre;
- d) të mbrojë interesat e Anëtarëve të saj dhe të ndihmojë Anëtarët për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve në mes tyre;
- e) të respektojë, kontrollojë dhe të parandalojë çdo shkelje të Statutit, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FIFA-së, të UEFA-së dhe të FFK-së, si dhe Ligjeve të Lojës dhe të sigurojë që këto edhe të respektohen nga anëtarët, ligat, shoqatat, klubet, lojtarët, zyrtarët, agjentët e ndeshjes dhe agjentët;
- f) të sigurojë që loja e futbollit të jetë në dispozicion dhe të ketë burime për të gjithë ata që dëshirojnë të marrin pjesë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga gjinia dhe moshë;
- g) të promovojë integritetin, etikën dhe lojën e ndershme me qëllim parandalimin e të gjitha metodave ose praktikave, të tilla si korrupsioni, dopingu ose manipulimi i ndeshjeve, të cilat mund të rrezikojnë integritetin e ndeshjeve, garave, lojtarëve, zyrtarëve dhe Anëtarëve ose të shkaktojnë abuzim të futbollit;
- h) të promovojë dhe forcojë parimet dhe praktikat e qeverisjes së mirë në nivel kombëtar dhe të inkurajojë Anëtarët e saj që të miratojnë parimet e tyre të qeverisjes së mirë;
- i) të promovojë zhvillimin e futbollit të femrave dhe pjesëmarrjen e plotë të femrave në të gjitha nivelet e qeverisjes së futbollit;
- j) të kontrollojë dhe mbikëqyrë të gjitha ndeshjet miqësore të futbollit të të gjitha formave që luhen në gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- k) të kontrollojë dhe mbikëqyrë futbollin e shoqatës, futsalit dhe futbollit në rërë në nivel kombëtar dhe të kontrollojë dhe mbikëqyrë të gjitha format e ndeshjeve ndërkombëtare të futbollit që luhen në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në përputhje me Statutin dhe rregulloret përkatëse të FIFA-së dhe UEFA-së;
- l) të menaxhojë marrëdhëniet sportive ndërkombëtare të lidhura me futbollin, futsalit dhe futbollin në rërë dhe të mirëmbajë marrëdhënie të mira dhe bashkëpunuese me shoqatat tjera, UEFA-në dhe FIFA-në;
- m) të organizojë dhe të jetë mikpritëse e garave ndërkombëtare dhe të tjera të lidhura me futbollin;
- n) të promovojë dhe mbështesë iniciativat e anëtarëve të saj për rritjen e të ardhurave të tyre;
- o) të mënjanoj konfliktin e interesit në organet, trupat dhe komisionet e FFK-së, dhe:

f) të parandalojë dhe sanksionojë dhunën dhe ngjarjet negative në sportin e futbollit sipas Ligjit Nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarje sportive.

---

### **Neni 3** Detyrimet

---

FFK merr përsipër:

- a) të investojë të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i saj për futbollin;
  - b) të respektojë në çdo kohë statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-së dhe UEFA-së, Kodin e Etikës së FIFA-së, vendimet e CAS-it, si dhe ligjet e Republikës së Kosovës, statutin e FFK-së dhe rregullore të tjera të detyrueshme për FFK-në;
  - c) të luajë rol aktiv lidhur me aktivitetet sportive të FIFA-së dhe UEFA-së;
  - d) të respektojë parimet e besnikërisë, integritetit dhe sportivitetit në frymën e lojës së ndershme;
  - e) të respektojë Ligjet e Lojës të miratuara nga IFAB, si dhe Ligjet e Futbollit të Rrërs dhe të Futsallit, të nxjerra nga FIFA;
  - f) të njohë juridiksionin e CAS-it, siç specifikohet në dispozitat përkatëse të statuteve të FIFA-së, UEFA-së dhe FFK-së;
  - g) të administrojë punët e saj në mënyrë të pavarur dhe të sigurojë që çështjet e veta të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë dhe të parashikojë një procedurë që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve të anëtarëve të organeve të FFK-së, në veçanti një procedurë e cila është e pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim i papërshtatshëm politik;
  - h) të veprojë në përputhje me konventat e antidopingut dhe dispozitat e tjera të legjislationit në fuqi;
  - i) të sigurojë që anëtarët, ligat, klubet, lojtarët, zyrtarët, ndërmjetësit dhe agjentët të bien dakord, se përmes statuteve të tyre, licencës, regjistrimit ose çdo dokumenti tjetër të shkruar, do të respektojnë detyrimet e sipërpërmendura;
  - j) t'ia komunikojë FIFA-së dhe UEFA-së çdo ndryshim të statutit të FFK-së përmes përkthimit, nëse është e nevojshme, në një gjuhë zyrtare të FIFA-së dhe UEFA-së.
- 

### **Neni 4** Të drejtat e njeriut

---

FFK angazhohet për respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht dhe përpiqet të promovojë mbrojtjen e tyre.

---

### **Neni 5** Mosdiskriminimi dhe barazia

---

Çfarëdo lloj diskriminimi kundër një vendi, personi privat ose grupi njerëzish për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes etnike, kombëtare ose sociale, gjinisë, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë, opinionit politik ose çfarëdo opinionit tjetër, pasurisë, lindjes ose ndonjë statusi tjetër, orientimi seksual ose ndonjë arsye tjetër, është rreptësisht e ndaluar dhe e dënueshme me pezullim ose përjashtim dhe / ose masa të tjera disiplinore.

---

## **Neni 6** Neutraliteti dhe pavarësia institucionale

---

1. FFK është neutrale në çështjet e politikës dhe fesë.
2. Anëtarët e FFK-së janë gjithashtu neutralë në çështjet politike dhe fetare dhe do të sigurojnë që edhe anëtarët e tyre të jenë neutral.
3. FFK mbetet e pavarur dhe shmangë çdo formë të ndërhyrjes së padrejtë politike. FFK menaxhon punët e saj në mënyrë të pavarur dhe siguron që punët e veta të mos ndikohen nga asnjë palë e tretë.

---

## **Neni 7** Promovimi i marrëdhënieve miqësore

---

1. FFK promovon marrëdhënie miqësore ndërmjet Anëtarëve të saj, klubeve, zyrtarëve dhe lojtarëve dhe në shoqëri për objektiva humanitare.
2. FFK siguron mjetet e nevojshme institucionale për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje të brendshme që mund të lindë ndërmjet Anëtarëve, klubeve, zyrtarëve dhe lojtarëve.

---

## **Neni 8** Lojtarët

---

Statusi i lojtarëve dhe dispozitat për regjistrimin dhe transferimin e tyre rregullohen me rregullore të posaçme të nxjerra nga Komiteti Ekzekutiv në përputhje me Rregulloren e FIFA-së për Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve. Vëmendje e duhur i kushtohet mbrojtjes së stabilitetit kontraktual dhe inkurajimit të stërvitjes dhe edukimit të lojtarëve nga klubet.

---

## **Neni 9** Ligjet e lojës

---

1. FFK dhe secili prej Anëtarëve të saj luajnë futboll në përputhje me Ligjet e Lojës të nxjerra nga IFAB. Vetëm IFAB mund të përcaktojë dhe të ndryshojë Ligjet e Lojës.
2. FFK dhe secili prej Anëtarëve të saj luajnë futsal në përputhje me Ligjet e Lojës për Futsall të nxjerra nga FIFA. Vetëm FIFA mund të përcaktojë dhe të ndryshojë Ligjet e Lojës së Futsallit.



3. FFK dhe secili nga Anëtarët e saj do të luajë futboll në rërë në përputhje me Ligjet e Lojës së Futbollit në Rërë të nxjerra nga FIFA. Vetëm FIFA mund të vendosë dhe të ndryshojë Ligjet e Lojës së Futbollit në Rërë.

---

**Neni 10**    **Sjellja e organeve, Zyrtarëve dhe të tjerëve**

---

1. Të gjitha organet dhe zyrtarët e FFK-së i respektojnë statutin, rregulloret, direktivat, vendimet, Kodin e Etikës të FIFA-së, të UEFA-së dhe të FFK-së në aktivitetet e tyre.

2. Çdo person, organ dhe organizatë e përfshirë në lojën e futbollit, futsall, dhe te tjera në territorin e Republikës së Kosovës, është i detyruar të respektojë Statutin dhe rregulloret e FIFA-së, të UEFA-së dhe të FFK-së dhe çdo akti tjetër përkatës, si dhe parimet e lojës së ndershme, besnikërisë, integritetit dhe sjelljes sportive.

---

**Neni 11**    **Gjuhët zyrtare**

---

1. Gjuha zyrtare e FFK-së është gjuha shqipe. Dokumentet dhe tekstet zyrtare (siç renditen në Nenin 85) shkruhen në këtë gjuhë.

2. Gjuha zyrtare në Kuvend është gjuha shqipe dhe çdo gjuhë tjetër zyrtare e Republikës së Kosovës që flitet dhe kërkohet nga Delegatët.

### **Neni 12** Pranimi, pezullimi dhe humbja e anëtarësimit

---

1. Kuvendi vendos nëse të pranojë, pezullojë ose përjashtojë një Anëtar.
2. Pranimi mund të miratohet nëse paraqitësi i kërkesës plotëson kërkesat e FFK-së në përputhje me këtë Statut. Komiteti Ekzekutiv mund të pranojë një paraqitës kërkesë për anëtarësim vetëm përkohësisht.
3. Anëtarësimi në FFK përfundon me anë të shpërbërjes, dorëheqjes ose përjashtimit. Humbja e anëtarësimit nuk e liron Anëtarin nga detyrimet e tij financiare ndaj FFK-së ose Anëtarëve të tjerë të FFK-së, por dërgon në humbjen e të gjitha të drejtave në lidhje me FFK-në. Komiteti Ekzekutiv mund të ndërmarrë çdo lloj hapi për të mbështetur Anëtarin, ose mund të detyrojë pasardhësin e tij ligjor të përmbushë të gjitha detyrimet financiare të Anëtarit të larguar para pranimit.

### **Neni 13** Anëtarët

---

1. Anëtarësimi në FFK është ekskluzivisht i hapur për personat juridik dhe shoqatat të cilët veprojnë dhe kanë selitë e tyre të regjistruara në Republikën e Kosovës. Anëtarësimi në FFK është i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë.
2. Anëtarët e FFK-së janë:
  - a) Lidhjet Rajonale të Futbollit:
    - i. Lidhja Rajonale e Futbollit – Prishtinë,
    - ii. Lidhja Rajonale e Futbollit - Mitrovicë,
    - iii. Lidhja Rajonale e Futbollit – Pejë,
    - iv. Lidhja Rajonale e Futbollit – Prizren,
    - v. Lidhja Rajonale e Futbollit – Ferizaj,
    - vi. Lidhja Rajonale e Futbollit – Gjilan, dhe
    - vii. Lidhja Rajonale e Futbollit – Gjakovë.
  - b) Klubet
  - c) Shoqatat profesionale të futbollit:
    - i. Shoqata e gjyqtarëve të futbollit – SHGJFK
    - ii. Shoqata e trajnerëve të futbollit – SHTFK
    - iii. Shoqata e futsallit – SHF;
    - iv. Shoqata e futbollit të femrave - SHFF

3. Lidhjet Rajonale të Futbollit, shoqatat profesionale të futbollit dhe klubet që marrin pjesë në Kampionatin e Super Ligës dhe në Kampionatin e Ligës së Parë janë anëtarë të drejtpërdrejtë të FFK-së. Të gjitha klubet tjera janë anëtarë jo të drejtpërdrejtë të FFK-së (d.m.th. janë të lidhur me një Lidhje Rajonale të Futbollit).

4. FFK mban një regjistër të Anëtarëve të saj dhe iu delegon Lidhjeve Rajonale të Futbollit detyrat për të menaxhuar informacionet rreth Anëtarëve të lidhur me to. Regjistri përfshin informacionin e mëposhtëm për secilin Anëtar:

- a) Certifikata e Klubit dhe/ose aktin e themelimit të shoqatës;
- b) Të dhënat dhe nënshkrimet e themeluesve të subjektit dhe emrat e personave të autorizuar për t'i përfaqësuar ata;
- c) Deklarata me shkrim për respektimin e Statutit dhe gjitha akteve normative të FFK-së, UEFA-së, FIFA-së
- d) Aktet normative të subjektit (Statuti, Rregullorja për Punën e Kuvendit dhe akte tjera sipas nevojës);
- e) Informacion shtesë në veçanti lidhur me licencimin e klubit (d.m.th. strukturën e klubit, identitetin; rezultatet), sipas vendimeve të Komitetit Ekzekutiv. Informacioni i përditësuar i lidhur me germa "a", "b" dhe "c" do të bëhet publik në faqen e internetit të FFK-së.

5. Me kërkesë paraprake, FFK konfirmon me shkrim statusin e Anëtarit.

---

## Neni 14 Pranimi

---

1. Çdo person juridik apo shoqatë që dëshiron të bëhet Anëtar i FFK-së paraqet kërkesë me shkrim në Sekretariatit e Përgjithshëm të FFK-së. Sekretari i Përgjithshëm ia konfirmon paraqitësit të kërkesës pranimin e kërkesës.

2. Kërkesa duhet të shoqërohet me pikat e mëposhtme të detyrueshme:

- a) një kopje të statutit ose rregullore të tyre ligjërish të vlefshme, dhe certifikatë të regjistrimit, nëse është e aplikueshme;
- b) një deklaratë se do t'i përmbahet në çdo kohë Statutit, rregulloreve dhe vendimeve të FFK-së, FIFA-së dhe UEFA-së dhe siguron që këto të respektohen, nëse është e aplikueshme, nga anëtarët e saj, klubet, zyrtarët dhe lojtarët;
- c) një deklaratë se do t'i përmbahet Ligjeve të Lojës në fuqi, siç përcaktohet nga IFAB si dhe Ligjeve të Futbollit në Rërë dhe Ligjeve të Lojës të Futsallit siç parashihet nga FIFA;
- d) një deklaratë se kandidati do të referojë në shkallën e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha mjeteve të brendshme brenda FFK-së) çdo mosmarrëveshje të dimensionit shtetëror që lind ose lidhet me Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FFK-së vetëm në një tribunal të pavarur të arbitrazhit dhe të krijuar në mënyrë të rregullt, i cili zgjidhë përfundimisht mosmarrëveshjen deri në përjashtimin e çfarëdo gjykate të zakonshme, përveç rasteve kur ndalohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës;
- e) një deklaratë se çdo mosmarrëveshje e dimensionit ndërkombëtar që lind ose lidhet me Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-së ose të UEFA-së, mund të dorëzohet vetëm në shkallën e fundit në CAS, siç specifikohet në Statutet e FIFA-së dhe të UEFA-së;
- f) një deklaratë se e njeh tribunalin e arbitrazhit të cilin FFK e ka njohur, siç specifikohet në këtë Statut, si dhe juridiksionin e CAS, siç specifikohet në Statutet e FIFA-së dhe të UEFA-së dhe vendimet e tij;
- g) një deklaratë me të cilën paraqitësi i kërkesës dëshmon se ai është i regjistruar dhe ka selinë e vet në në territorin e Republikës së Kosovës;

- h) një deklaratë që përbërja ligjore e paraqitësit të kërkesës garanton se ai mund të marrë vendime në mënyrë të pavarur nga çdo subjekt i jashtëm nga çdo ndërhyrje ose ndikim i papërshtatshëm politik;
- i) një deklaratë që thotë se anëtarët e organeve të veta janë zgjedhur ose emëruar si rezultat i një procedure që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjes ose emërimit;
- j) një listë të zyrtarëve, ku specifikohen ata që janë nënshkrues të autorizuar me të drejtën për të lidhur marrëveshje ligjërisht të detyrueshme me palët e treta;
- k) një kopje të procesverbalit të Kuvendit ose mbledhjes së tij të fundit konstituente;
- l) nëse është e aplikueshme, një deklaratë që merr përsipër të organizojë ose të marrë pjesë në ndeshje miqësore vetëm me pëlqimin paraprak të FFK-së; dhe
- m) nëse është e aplikueshme, një deklaratë se do të luajë të gjitha ndeshjet zyrtare pritëse në territorin e Republikës së Kosovës, përpos nëse vendoset ndryshe nga autoritetet kompetente.

---

## **Neni 15** Kërkesa dhe procedura për paraqitje të kërkesës

---

1. Procedura e pranimit rregullohet me këtë Statut.
2. Sekretari i Përgjithshëm verifikon përmbushjen e kërkesave të parashikuara në këtë Statut dhe përgatit një raport me shkrim për Komitetin Ekzekutiv.
3. Komiteti Ekzekutiv shqyrton raportin me shkrim dhe vendos nëse kërkesa për anëtarësim i plotëson të gjitha kërkesat, dhe nëse po, Komiteti Ekzekutiv i kërkon Kuvendit të pranojë ose jo kërkesën për pranim ose jo. Paraqitësi i kërkesës mund të deklarojë arsyet e kërkesës të tij para Kuvendit dhe/ose para Komitetit Ekzekutiv.
4. Anëtari i ri fiton të drejtat dhe detyrat e anëtarësimit sapo të jetë pranuar nga Kuvendi ose i pranuar përkohësisht nga Komiteti Ekzekutiv. Delegatët e tij kanë të drejtë të votojnë dhe të zgjedhen me efekt të menjëhershëm vetëm pasi të jenë pranuar.

---

## **Neni 16** Të drejtat e anëtarëve

---

1. Anëtarët e FFK-së kanë këto të drejta si në vijim:
  - a) të marrin pjesë në Kuvend, të marrin paraprakisht rendin e ditës, të thirren në Kuvend brenda afatit të caktuar, të ushtrojnë të drejtat e tyre për të marrë pjesë në debate dhe diskutime dhe për të ushtruar të drejtat e tyre të votës (e aplikueshme vetëm për Anëtarët me anëtarësi të drejtpërdrejtë);
  - b) të hartojnë propozime për përfshirje në rendin e ditës të Kuvendit (Anëtarët me anëtarësi jo të drejtpërdrejtë i drejtojnë propozimet e tyre nëpërmjet Lidhjeve të tyre përkatëse Rajonale të Futbollit);
  - c) të propozojnë kandidatë për zgjedhje dhe/ose emërim në organet përkatëse të FFK-së (e aplikueshme vetëm për Anëtarët me anëtarësim të drejtpërdrejtë);
  - d) të informohen për punët e FFK-së nëpërmjet organeve të tyre zyrtare dhe të informohen për vendimet përkatëse të marra nga Komiteti Ekzekutiv;

e) të marrin pjesë në gara (nëse është e aplikueshme) dhe/ose aktivitete të tjera sportive të organizuara nga FFK dhe të organizojnë kampionate (nëse është e aplikueshme) pas caktimit nga FFK dhe nën patronazhin e FFK-së;

f) të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tjera që rrjedhin nga Statuti dhe rregulloret e FFK-së; dhe

g) të nxjerrin rregullore vetëm në lidhje me funksionet administrative dhe të organizimit (nëse është relevante).

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave i nënshtrohet dispozitave të tjera të Statutit dhe rregulloreve në fuqi të FFK-së.

---

## Neni 17 Detyrimet e Anëtarëve

---

1. Anëtarët e FFK-së kanë këto detyrime:

a) të jenë në përputhje të plotë me Statutin, rregulloret, direktivat, vendimet dhe çdo akt tjetër të FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së gjatë gjithë kohës dhe të sigurojnë që këto të respektohen edhe nga Anëtarët, lojtarët dhe zyrtarët e tyre;

b) të sigurojnë zgjedhjen e organeve të tyre vendimmarrëse të paktën çdo katër (4) vjet;

c) të marrin pjesë në gara (nëse është e aplikueshme) dhe aktivitete të tjera sportive të organizuara nga FFK;

d) të mbledhin organin e tyre më të lartë (legjislativ) së paku një (1) herë në vit;

e) të paguajnë abonimet e tyre të anëtarësisë dhe të jenë të qëndrueshëm sa i përket detyrimeve të tyre financiare, siç përcaktohet në këtë Statut ose akt tjetër të FFK-së;

f) të respektojnë Ligjet e Lojës të përcaktuara nga IFAB, si dhe Ligjet e Lojës për Futboll në Rrëz dhe Futsall siç janë të përcaktuara nga FIFA dhe të sigurojnë që këto të respektohen gjithashtu nga Anëtarët, lojtarët dhe zyrtarët e saj përmes një dispozite në statut;

g) të miratojnë një klauzolë statutores që specifikon se çdo mosmarrëveshje e dimensionit shtetëror që lind ose lidhet me Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FFK-së mund të referohet vetëm në shkallën e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha kanaleve të brendshme brenda FFK-së, në një tribunal të pavarur të arbitrazhit dhe e formuar në mënyrë të rregullt, e cila zgjidhë përfundimisht mosmarrëveshjen duke përjashtuar çdo gjykatë të zakonshme, përveç rasteve kur ndalohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës.

h) të miratojnë një klauzolë statutores që specifikon se çdo mosmarrëveshje e dimensionit ndërkombëtar që lind ose lidhet me Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-së, UEFA-së ose të FFK-së mund të paraqitet vetëm në shkallën e fundit vetëm në CAS, siç specifikohet në Statutet e FIFA-së, UEFA-së dhe FFK-së.

i) të menaxhojnë punët e tyre në mënyrë të pavarur dhe të sigurojnë që punët e tyre të mos ndikohen nga asnjë palë e tretë, në përputhje me Nenin 22 të këtij Statuti;

j) të sigurojnë që organet e tyre të zgjidhen ose të emërohen sipas një procedure që garanton pavarësinë dhe integritetin e plotë të procesit të zgjedhjes ose emërimeve;

- k) t'i komunikojnë FFK-së çdo ndryshim të Statutit, aktit më të lartë, rregulloreve të saj si dhe ndryshimet në organizimin e vet të brendshëm (p.sh. listën e zyrtarëve të saj që janë nënshkrues të autorizuar me të drejtën për të lidhur marrëveshje ligjrisht të detyrueshme me palët e treta);
- l) t'i komunikojnë FFK-së së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së mbledhjeve të Kuvendeve të tyre të rregullta dhe të jashtëzakonshëm;
- m) të mos mbajnë asnjë marrëdhënie të natyrës sportive me subjekte që nuk njihen ose me Anëtarë që janë pezulluar ose përjashtuar;
- n) të respektojnë parimet e besnikërisë, integritetit dhe sjelljes së mirë sportive si shprehje e lojës së ndershme nëpërmjet një dispozite statutore dhe të sigurojnë që ato të respektohen edhe nga anëtarët e tyre nëpërmjet një dispozite statutore;
- o) të respektojnë pikat e detyrueshme të përcaktuara në Nenin 14 paragrafi 2 i këtij Statuti për kohëzgjatjen e përkatësisë së tyre;
- p) të administrojnë një regjistër anëtarësh i cili përditësohet rregullisht;
- q) të ratifikojnë statute që janë në përputhje me kërkesat e këtij Statuti;
- r) të jenë plotësisht në përputhje me të gjitha detyrat tjera që rrjedhin nga Statutet dhe rregulloret e FIFA-së, UEFA-së dhe FFK-së.

2. Anëtarët duhet të integrojnë në statutin e tyre ose në aktin më të lartë, detyrimet që rrjedhin nga Statutet dhe rregulloret tjera të FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së.

3. Shkelja e detyrimeve të sipërpërmendura nga çdo Anëtar mund të çojë në sanksione të parapara në këtë Statut ose akte të tjera të FFK-së.

4. Shkelja e paragrafit 1 i) më sipër gjithashtu mund të rezultojë në sanksione, edhe në qoftë se ndikimi i palës së tretë nuk ishte gabim i Anëtarit në fjalë. Secili Anëtar i FFK-së është përgjegjës ndaj çdo dhe të gjitha akteve të anëtarëve të organeve të tyre të shkaktuar nga neglizhenca e plotë ose sjellja e keqe ose e gabuar e atyre anëtarëve.

---

## Neni 18 Pezullimi

---

1. Kuvendi është përgjegjës për pezullimin e një Anëtari. Megjithatë, Komiteti Ekzekutiv mund të pezullojë përkohësisht me efekt të menjëhershëm një anëtar që shkel seriozisht dhe/ose në mënyrë të përsëritur detyrimet e tij si anëtar, para se të votohet në Kuvend. Pezullimi i miratuar nga Komiteti Ekzekutiv zgjatë deri në Kuvendin e ardhshëm, përveç rastit kur Komiteti Ekzekutiv e ka hequr atë ndërkohë.

2. Mocioni për pezullim duhet të miratohet nga shumica e dy të tretave (2/3) të votave të vlefshme. Pezullimi i një Anëtari nga Kuvendi ose pezullimi i përkohshëm nga Komiteti Ekzekutiv konfirmohet në Kuvendin e ardhshëm. Nëse nuk konfirmohet, pezullimi hiqet automatikisht.

3. Anëtari në fjalë ka të drejtën të dëgjohet nga Kuvendi dhe mund t'i përgjigjet me shkrim propozimit për pezullim. Përgjigja duhet t'i dërgohet Anëtarëve bashkë me njoftimin për thirrjen e Kuvendit në përputhje me Nenin 33 paragrafi 4 dhe nenin 35 paragrafi 4 ose Komitetit Ekzekutiv në përputhje me nenin 40 paragrafi 3.

4. Një Anëtar i pezulluar mund të humbasë të drejtat e tij të anëtarësisë. Anëtarët e tjerë nuk mund të kenë kontakt sportiv me një Anëtar të pezulluar. Komisioni Disiplinor dhe i Etikës mund të vendosë sanksione të mëtejshme.

5. Anëtarët që nuk marrin pjesë në aktivitetet sportive të FFK-së për një (1) vit kalendarik radhazi pezullohen nga votimi në Kuvend dhe përfaqësuesit e tyre nuk zgjedhen ose emërohen derisa të kenë përmbushur detyrimet e tyre në këtë drejtim.

---

## Neni 19 Përrjashtimi

---

1. Kuvendi mund të përjashtojë një anëtar nëse:

- a) ai shkel rëndë dhe në mënyrë të përsëritur Statutin, rregulloret, direktivat, vendimet, ose akte tjera të FFK-së, FIFA-së dhe UEFA-së;
- b) Nuk arrin të përmbushë kërkesat e anëtarësimit të përcaktuara në këtë Statut;
- c) Nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij financiare ndaj FFK-së;
- d) Nuk merr pjesë në aktivitetet sportive të FFK-së për tre (3) sezone radhazi.

2. Komiteti Ekzekutiv ka të drejtë vetëm të propozojë përjashtimin e një Anëtarit.

3. Mocioni për përjashtim duhet të miratohet nga tri të katërtat e shumicës së votave të vlefshme.

4. Anëtarit në fjalë ka të drejtë të dëgjohet nga Kuvendi dhe gjithashtu mund t'i përgjigjet me shkrim propozimit të Komitetit Ekzekutiv për përjashtimin e Anëtarit në fjalë. Përgjigjja u dërgohet Anëtarëve së bashku me ftesën zyrtare të Kuvendit në pajtim me nenin 33, paragrafi 4 dhe nenin 35, paragrafi 4.

---

## Neni 20 Dorëheqja

---

1. Një anëtar mund të japë dorëheqjen nga FFK me efekt nga fundi i një sezoni futbollistik (30 qershor). Njoftimi i dorëheqjes duhet të arrijë në Sekretariatit e Përgjithshëm jo më vonë se gjashtë (6) muaj para përfundimit të sezonit futbollistik.

2. Dorëheqja nuk është e vlefshme derisa anëtarit që dëshiron të japë dorëheqjen të ketë përmbushur detyrimet e tij financiare ndaj FFK-së dhe Anëtarëve të tjerë të saj.

---

## Neni 21 Shpërbërja

---

1. Nëse një Anëtar shpërbëhet, qoftë vullnetarisht ose për shkaqe ligjore, anëtarësia e tij në FFK përfundon me efekt të menjëhershëm në momentin që pushon së ekzistuari personaliteti i tij juridik.

2. Organi ekzekutiv i Anëtarit do të informojë Sekretariatit e Përgjithshëm të FFK-së për fillimin e procedurës së shpërbërjes. Rrjedhimisht, Sekretariati i Përgjithshëm i FFK-së do të njoftojë në përputhje me rrethanat Komitetin Ekzekutiv.

---

## **Neni 22** Pavarësia e Anëtarëve dhe organeve të tyre

---

1. Çdo Anëtar menaxhon punët e veta në mënyrë të pavarur dhe pa ndikim të panevojshëm nga palët e treta.
2. Organet e Anëtarëve zgjedhen ose emërohen. Statutet ose akte tjera më të larta të Anëtarëve parashikojnë procedura demokratike që garantojnë pavarësinë dhe integritetin e plotë të procesit të zgjedhjes ose emërimeve.
3. Organet e Anëtarëve që nuk janë zgjedhur apo emëruar në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 më sipër, edhe mbi bazë të përkohshme, nuk njihen nga FFK.
4. Vendimet e marra nga organet që nuk janë zgjedhur apo emëruar në përputhje me paragrafin 2 më sipër, nuk njihen nga FFK.

---

## **Neni 23** Statusi i klubeve, ligave, lidhjeve rajonale dhe grupeve të tjera të klubeve

---

1. Klubet, ligat, Lidhjet Rajonale të Futbollit ose çdo grup tjetër të lidhura me FFK-në, janë në varësi dhe të njohura nga FFK. Është vetëm një kampionat kombëtar të nivelit më të lartë në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Ky Statut përcakton fushëveprimin e autoritetit dhe të drejtat dhe detyrat e subjekteve të përmendura në paragrafin 1 më sipër. Statuti dhe/ose rregulloret e tyre janë në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e Statutit dhe rregulloret e FFK-së. FFK ka përgjegjësinë kryesore për të rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me referimin, luftën kundër dopingut, regjistrimin e lojtarëve, licencimin e klubeve, vendosjen e masave disiplinore, përfshirë për sjellje të pahijshme etike, si dhe masat e nevojshme për të mbrojtur integritetin e garave përfshirë edhe luftën kundër kurdisjeve të ndeshjeve.
3. Subjektet e përmendura në paragrafin 1 më sipër, marrin të gjitha vendimet për çdo çështje në lidhje me anëtarësimin e tyre, pavarësisht nga çdo organ i jashtëm. Ky detyrim zbatohet pavarësisht nga struktura e tyre e organizimit.
4. Në çfarëdo rasti, asnjë person fizik ose juridik (përfshirë kompanitë aksionare dhe filialet) nuk ushtrojnë kontroll në asnjë mënyrë, mbi më shumë se një klub ose grup klubesh kurdo që mund të rrezikohet integriteti i ndonjë ndeshjeje ose gare.



**Neni 24**    **President Nderi dhe Anëtar Nderi**

---

1. Kuvendi mund t'i jap titullin president nderi ose anëtar nderi çdo personi për shërbimin e merituar ndaj futbollit. Në mënyrë që kërkesa të miratohet, kërkohet shumica e dy të tretave (2/3) të votave të vlefshme.
2. Komiteti Ekzekutiv i bën këto nominime. President nderi propozohet vetëm një individ i cili ka kryer më parë detyrën e Presidentit të FFK-së. Anëtar nderi mund të propozohet vetëm një individ i cili ka qenë anëtar i organeve të FFK-së.
3. Presidenti i nderit mund të merr pjesë në Kuvend dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe të përfshihet në diskutime, por nuk ka të drejtë vote. Anëtari i nderit mund të marrë pjesë në Kuvend duke u përfshirë në diskutime, por nuk ka të drejtë vote.

## Neni 25 Organet

---

1. Kuvendi është organi më i lartë dhe legjislativ.
2. Komiteti Ekzekutiv është organi strategjik, vendimmarrës dhe mbikëqyrës, i cili drejtohet nga Presidenti i FFK-së.
3. Sekretariati i Përgjithshëm është organi ekzekutiv, operativ dhe administrativ.
4. Komisionet e përhershme dhe ato ad hoc këshillojnë dhe ndihmojnë Komitetin Ekzekutiv dhe Sekretariatit e Përgjithshëm në përmbushjen e detyrave të tyre.
5. Organet e licencimit të klubeve janë përgjegjëse për sistemin e licencimit të klubeve në kuadër të FFK-së.
6. Komisionet e pavarura kryejnë funksionet e tyre në përputhje me këtë Statut dhe rregulloret në fuqi. Komisionet e pavarura janë:
  - a) Komisioni Mbikëqyrës;
  - b) Komisioni Zgjedhor; dhe
  - c) Organet gjyqësore.
7. Organet gjyqësore janë:
  - a) Komisioni Disiplinor dhe i Etikës;
  - b) Komisioni i Ankesave; dhe
  - c) Inspektorët Disiplinor.
8. Organet zgjedhen ose emërohen nga vetë FFK pa ndonjë ndikim të jashtëm të panevojshëm dhe në përputhje me procedurat e përshkruara në këtë Statut.
9. Çdo anëtar i organeve duhet të tërhiqet nga debati dhe nga marrja e vendimeve nëse ekziston ndonjë rrezik apo mundësi për konflikt interesi. Në veçanti, anëtarët e organeve janë gjithmonë të vetëdijshëm dhe respektojnë dispozitat përkatëse të Kodit të Etikës të FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së për konfliktin e interesit dhe të përshtatin sjelljen e tyre sipas nevojës (d.m.th.. të përmbahen nga kryerja e detyrave të tyre, të njoftojnë kryesuesin në rastet e konflikteve të mundshme të interesit, etj.).

---

## Neni 26 Shkarkimi i një anëtari të një organi

---

1. Kuvendi gjithashtu mund të shkarkojë një anëtar të një organi. Komiteti ekzekutiv mund të shkarkojë një anëtar të një organi përkohësisht, me përjashtim të anëtarëve të komisioneve të pavarura. Shkarkimi i përkohshëm i miratuar nga Komiteti Ekzekutiv mbetet në fuqi deri në Kuvendin e ardhshëm, përveç rastit kur Komiteti Ekzekutiv e ka hequr atë në ndërkohë. Nëse Kuvendi i ardhshëm është i natyrës zgjedhore, një anëtar

i shkarkuar lejohet të jetë kandidat zgjedhor (me kusht që anëtari në fjalë të plotësojë kriteret përkatëse të pranueshmërisë), në varësi të vendimit përfundimtar të Kuvendit për shkarkimin e tij që merret para zgjedhjeve.

2. Mocioni për shkarkim duhet të jetë i arsyetuar dhe iu dërgohet anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv dhe/ose Anëtarëve të FFK-së së bashku me rendin përkatës të ditës.

3. Anëtari i organit në fjalë ka të drejtë të mbrohet para Komitetit Ekzekutiv dhe/ose Kuvendit.

4. Mocioni për shkarkim vendoset me votim të fshehtë ose të hapur në Komitet Ekzekutiv dhe/ose në Kuvend. Për të miratuar kërkesën, kërkohet shumica e dy të tretave (2/3) të votave të vlefshme.

5. Anëtari i shkarkuar (përkohësisht ose jo) lirohet nga funksionet e tij me efekt të menjëhershëm.

**Neni 27** Përkufizimi dhe Përbërja

---

1. Kuvendi është mbledhja në të cilën të gjithë Anëtarët me të drejtë vote mbledhen rregullisht dhe përfaqësohen nga delegatët legjitim. Kuvendi përfaqëson autoritetin më të lartë dhe legjislativ të FFK-së. Vetëm një Kuvend që mbledhet me procedure të rregullt, ka autoritetin për të marrë vendime. Kuvendi mund të mbahet personalisht, me video-konferencë ose në një format të përzier.
2. Kuvendi konstituohet në përputhje me parimet e demokracisë përfaqësuese dhe merr parasysh rëndësinë e barazisë gjinore në futboll, interesin e futbollit të femrave dhe përfaqësimin e shoqatave në futboll.
3. Kuvendi mund të jetë i rregullt ose i jashtëzakonshëm.
4. Presidenti kryeson Kuvendin në përputhje me këtë Statut, rregulloret e Kuvendit si dhe çdo rregullore tjetër në fuqi.
5. Komiteti Ekzekutiv mund të emërojë vëzhgues që marrin pjesë në Kuvend, pa të drejtë debati ose votimi.

---

**Neni 28** Delegatët dhe votat

---

1. Kuvendi përbëhet nga Anëtarët me anëtarësi të drejtpërdrejtë si më poshtë:
  - a) Klubet që marrin pjesë në Kampionatin e Superligës (kategoria e parë): 2 delegatë secili;
  - b) Klubet që marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar të Ligës së Parë (kategoria e dytë): 1 delegat secili;
  - c) Lidhjet Rajonale të Futbollit: 2 delegatë secila;
  - d) Shoqatën e Trajnerëve: 1 delegat;
  - e) Shoqata e Gjyqtarëve të Futbollit: 1 delegat;
  - g) Shoqata e Futbollit të Femrave: 1 delegat;
  - h) Shoqata e Futsallit: 1 delegat.
2. Delegatët duhet t'i përkasin Anëtarit që përfaqësojnë dhe të emërohen ose zgjedhen nga organi legjitim i atij Anëtari. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje ta dëshmojnë këtë me kërkesë të Komisionit Zgjedhor. Në rrethana përjashtuese, një Anëtar mund të ndryshojë emrin e delegatit(ëve) pas afatit të caktuar por jo më vonë se 15 ditë nga dita e mbledhjes së Kuvendit.
3. Çdo delegat ka një votë në Kuvend. Të drejtë vote kanë vetëm delegatët e pranishëm. Pjesëmarrja me video-konferencë konsiderohet prezencë. Nuk lejohet votimi me autorizim ose me letër. Kur një Kuvend mbahet me video-konferencë, lejohet votimi në internet.
4. Klubet që marrin pjesë me klube të ndryshme në Kampionatin e Superligës (kategoria e parë) dhe Kampionatin Kombëtar të Ligës së Parë (kategoria e dytë) në kohën e Kuvendit, kanë të drejtën e maksimumit prej dy (2) delegatësh. Një Klub që promovohet në Kampionatin Kombëtar të Ligës së Parë automatikisht konsiderohet anëtar i drejtpërdrejt i FFK-së kurse një Klub që bie nga Kampionati i Ligës së Parë më nuk

konsiderohet anëtar i drejtpërdrejtë i FFK-së. Data e fundit është miratimi i renditjes nga Komiteti Ekzekutiv në fund të sezonit përkatës.

5. Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv dhe Sekretari i Përgjithshëm marrin pjesë në Kuvend pa të drejtë vote. Gjatë mandatit të tyre, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv nuk mund të emërohen si delegatë në Kuvend.

---

## Neni 29 Fushat e kompetencave

---

Kuvendi ka kompetencat si vijon:

- a) miratimin ose ndryshimin e këtij Statuti, Rregullores së Kuvendit dhe të Kodit Zgjedhor të FFK-së;
- b) emërimin e një (1) Anëtari për të kontrolluar procesverbalin dhe miratimin e procesverbalit të mbledhjes së fundit;
- c) zgjedhjen e Presidentit dhe të anëtarëve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv të cilët janë paraprakisht zgjedhura dhe/apo propozuar nga Lidhjet Rajonale (7 anëtarë), nga Presidenti (3 anëtarë) dhe të tjerët nga Anëtarët;
- d) zgjedhjen e kryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura (d.m.th. Komisionit Mbikëqyrës, Komisionit Zgjedhor dhe Organeve Gjyqësore), me propozim të Komitetit Ekzekutiv;
- e) caktimin e kontrollorëve për numërimin e votave dhe për të ndihmuar Komisionin Zgjedhor në shpërndarjen e fletëve të votimit të lëshuara për zgjedhjet, nëse zgjedhjet zhvillohen me votim të fshehtë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore të audituara, përfshirë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin vjetor;
- g) miratimin e buxhetit;
- h) miratimin e raportit të veprimtarisë (që përmban aktivitetet e FFK-së që nga Kuvendi i kaluar);
- i) emërimin e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm me propozim të Komitetit Ekzekutiv;
- j) caktimin e anëtarësimit me propozim të Komitetit Ekzekutiv;
- k) dhënien e titullit president nderi ose anëtar nderi, me propozim të Komitetit Ekzekutiv;
- l) pranimin, pezullimin ose përjashtimin e një Anëtari kur vendos Kuvendi;
- m) shkarkimin e një anëtari të ndonjë organi të FFK-së të propozuar nga Komiteti Ekzekutiv ose Anëtarët;
- n) shpërbërjen e FFK-së dhe marrjen e vendimit për shfrytëzimin e aseteve të saj financiare; dhe
- o) miratimin e vendimeve me kërkesë të një Anëtari në përputhje me këtë Statut ose miratimin e çdo vendimi që i është besuar Kuvendit në përputhje me këtë Statut.

---

## Neni 30 Kuorumi

---

1. Vendimet e miratuara nga Kuvendi janë të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm shumica (më shumë se 50%) e delegatëve që përfaqësojnë Anëtarët me të drejtë vote, me përjashtim të rasteve të specifikuara në paragrafin 5 të këtij neni.
2. Nëse nuk arrihet kuorumi, Kuvendi i dytë mbahet brenda një kohe sa më të shkurtër (mundet brenda 72 orë) me të njëjtin rend dite.
3. Nuk kërkohet kuorum për mbledhjen e dytë të Kuvendit, përveç nëse një pikë në rendin e ditës propozon (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zgjedhjen, pezullimin/largimin e Presidentit ose të anëtarëve të mbetur të Komitetit Ekzekutiv, (iii) zgjedhjen e kryetarëve ose anëtarëve të komisioneve të pavarura, (iv) shkarkimin e një anëtari të një organi, (v) pezullimin ose përjashtimin e një anëtari ose (vi) shpërbërjen e FFK-së.
4. Pasi shpallet se Kuvendi është thirrur dhe përbërë në përputhje me këtë Statut, kuorumi nuk ndikohet nga delegatët që largohen.
5. Vendimet e miratuara nga Kuvendi janë të vlefshme vetëm nëse dy të tretat (2/3) e delegatëve që përfaqësojnë Anëtarët me të drejtë vote janë të pranishëm për (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) shpërbërjen e FFK-së dhe (iii) zgjedhjen, pezullimin dhe largimin e Presidentit.

---

## Neni 31 Vendimet

---

1. Vendimet që hidhen në votim merren me ngritjen e dorës, me numërim elektronik ose me votim të fshehtë me zarf, përveç rasteve kur Kuvendi vendos ndryshe. Nëse ngritja e dorës nuk rezulton në një shumicë të qartë në favor të një kërkesë ose nëse të paktën një e treta (1/3) e delegatëve që përfaqësojnë Anëtarët e pranishëm me të drejtë vote e kërkojnë atë, votimi merret duke thirrur listën sipas rendit alfabetik.
2. Nëse një vendim nuk parashikohet ndryshe në këtë Statut, mjafton shumica (më shumë se 50%) e votave të vlefshme të hedhura që një vendim të jetë i vlefshëm. Fletët e votimit bosh, votat e pavlefshme ose votat elektronike të manipuluar në çfarëdo mënyre si dhe abstenimet nuk merren parasysh gjatë llogaritjes së shumicës.

---

## Neni 32 Zgjedhjet

---

1. Zgjedhjet zhvillohen me votim të fshehtë ose të hapur. Megjithatë, nëse numri i kandidatëve është i barabartë me numrin e vendeve vakante, Kuvendi mund të vendosë të procedojë ndryshe.
2. Zgjedhjet zhvillohen në pajtim me Kodin Zgjedhor të FFK-së dhe mbikëqyren nga Komisioni Zgjedhor.
3. Zgjedhja bëhet sipas pozicionit si më poshtë (në rend kronologjik):
  - a) Zgjedhja e Presidentit;
  - b) Zgjedhja e kandidatëve për Komitetin Ekzekutiv që përfaqësojnë interesat e Lidhjeve Rajonale të Futbollit; dhe

- c) Zgjedhja e kandidatëve për Komitetin Ekzekutiv që përfaqësojnë interesat e Anëtarëve të tjerë.
4. Çdo kandidat në zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv propozohet nga Anëtarët e Kuvendit. Secili Anëtar mbështet vetëm një kandidat për secilën kategori të pozitës. Nëse një Anëtar mbështet më shumë se një kandidat, asnjë nga shprehjet e tij për të mbështetur këtë kategori të pozitës nuk konsiderohen të vlefshme.
5. Çdo kandidat në zgjedhjen e Presidentit propozohet nga së paku pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve. Çdo anëtar mbështet vetëm një kandidat për President. Nëse një anëtar mbështet më shumë se një kandidat, asnjë nga shprehjet e tij të mbështetjes për këtë kategori pozicionesh nuk konsiderohet e vlefshme. Një shumicë (më shumë se 50%) e votave të vlefshme të hedhura është e nevojshme për zgjedhjen e Presidentit dhe një kuorum prej dy të tretat (2/3) e delegatëve që përfaqësojnë Anëtarët me të drejtë vote janë të pranishëm në raundin e parë. Nëse ka më shumë se dy kandidatë për postin e Presidentit, kushdo që merr numrin më të vogël të votave eliminohet pas çdo votimi derisa të mbeten vetëm dy kandidatë; në këtë rast, zgjidhet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.
6. Për zgjedhjen e anëtarëve të mbetur të Komitetit Ekzekutiv, kandidati(ët) renditen sipas kategorisë së pozicionit dhe sipas rendit alfabetik. Çdo Anëtar mund të votojë për aq kandidatë sa ka vende të lira në një raund të caktuar. Një kandidat zgjedhet në raundin e parë nëse mbështetet nga shumica e votave të vlefshme të hedhura (d.m.th. më shumë se 50%). Nëse nuk ka kandidatë të mjaftueshëm me shumicë absolute për të plotësuar vendet e lira, mbahet raundi i dytë për të cilin mjafton një shumicë e thjeshtë (d.m.th. numri më i madh i votave) që një kandidat të zgjedhet për pozicionin e mbetur. Në rast barazimi, zhvillohet raundi i tretë për të cilin mjafton shumica e thjeshtë. Në rast të një barazimi të mëtejshëm, rezultati i zgjedhjeve përcaktohet me short të mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm dhe i monitoruar nga Komisioni Zgjedhor.
7. Për zgjedhjen e kryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura (d.m.th. Komisionit Mbikëqyrës, Komisionit Zgjedhor dhe Organeve Gjyqësore), zgjedhen kandidati(ët) që merr(arrin) më së shumti vota në lidhje me mandatin(et) e lirë. Këto zgjedhje mund të zhvillohen në bllok, përmes listave. Megjithatë, me kërkesë të së paku pesëmbëdhjetë (15) delegatëve që përfaqësojnë Anëtarët, bëhet një votim i veçantë për një kandidat specifik.
8. Përveç kërkesave të mësipërme, për zgjedhjen e Presidentit, anëtarëve të mbetur të Komitetit Ekzekutiv, kryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura, kandidati(ët) duhet të plotësojnë kërkesat e mëtejshme të mëposhtme:
- a) të jetë shtetas i Kosovës me vendbanim të përhershëm në Kosovë;
  - b) të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në Kapitullin XXXIII të Kodit Penal të Kosovës që kanë të bëjnë me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrave zyrtare, si dhe të mos jenë dënuar për kurdisje të ndeshjeve nga organet e FIFA-së, UEFA-së apo FFK-së;
  - c) të jep një deklaratë me shkrim ku personi deklaron se jep dorëheqje nga funksionet e tij brenda FFK-së dhe/ose anëtarëve të saj, nëse zgjedhet;
  - e) të jetë i kualifikuar për rolin;
  - f) të kenë qenë tashmë aktivë në organizim të futbollit – anëtarë të drejtëpërdrejt të FFK-së në pesë (5) vitet e fundit (ky kriter nuk aplikohet për kandidatët për pozita në komisione të pavarura);
  - h) të mos jetë i dënuar apo suspenduar nga organet disiplinore të FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së;
  - g) të mos jenë ose të mos kenë qenë deputetë, kandidatë për deputetë, anëtarë të organeve drejtuese në asnjë parti politike ose funksionarë politikë, zyrtar i zgjedhur publik, emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike, në pesë (5) vitet e fundit.
9. Kandidaturat për cilindo nga pozitat e Presidentit ose të Komitetit Ekzekutiv i dërgohen Sekretariatit të Përgjithshëm së paku njëzet (20) ditë para Kuvendit përkatës. Kandidatët e pavarur do të verifikohen nga Komisioni Zgjedhor dhe lista zyrtare e kandidatëve të miratuar nga Komisioni i sipërpërmendur. Lista zyrtare e kandidatëve duhet t'iu dërgohet Anëtarëve të FFK-së paku shtatë (7) ditë para Kuvendit në të cilin zgjidhet

Komiteti Ekzekutiv. Dispozitat e këtij paragrafi zbatohen edhe kur mbahen zgjedhjet gjatë Kuvendit të Jashtëzakonshëm.

10. Kandidaturat për cilindo nga pozitat e komisioneve të pavarura (d.m.th. Komisionit Mbikëqyrës, Komisionit Zgjedhor dhe Organeve Gjyqësore) i dërgohen Sekretariatit të Përgjithshëm të paktën njëzetë (20) ditë para Kuvendit zgjedhor përkatës. Lista zyrtare e kandidatëve duhet t'u kalojë Anëtarëve të FFK-së së paku shtatë (7) ditë para Kuvendit në të cilin zgjedhen anëtarët në fjalë.

---

### **Neni 33** Kuvendi i Rregullt

---

1. Kuvendi i Rregullt mbahet së paku një herë (1) në vit.
2. Komiteti Ekzekutiv cakton vendin dhe datën. Anëtarët njoftohen me shkrim së paku tridhjetë (30) ditë përpara. FIFA, UEFA dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve njoftohen gjithashtu nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Çdo propozim që një Anëtar dëshiron t'ia paraqesë Kuvendit, i dërgohet Sekretariatit të Përgjithshëm me shkrim, me një shpjegim të shkurtër, së paku njëzet (20) ditë para datës së Kuvendit.
4. Thirrja formale bëhet me shkrim së paku shtatë (7) ditë para datës së Kuvendit. Kjo thirrje përmban rendin e ditës, raportin e punës, pasqyrat financiare, raportin e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm dhe çdo dokument tjetër përkatës, duke përfshirë listën e kandidatëve zyrtarë (nëse është e nevojshme).

---

### **Neni 34** Rendi i Ditës i Kuvendit të Rregullt

---

1. Sekretari i Përgjithshëm harton rendin e ditës në bazë të propozimeve të Komitetit Ekzekutiv dhe të Anëtarëve të Kuvendit.
2. Rendi i ditës i Kuvendit përfshin pikat e mëposhtme të detyrueshme (në mënyrë kronologjike):
  - a) një deklaratë se Kuvendi është thirrur dhe përbëhet në përputhje me këtë Statut;
  - b) miratimin e rendit të ditës;
  - c) një fjalim të Presidentit;
  - d) emërimi i Anëtarëve për të kontrolluar procesverbalin;
  - e) emërimi i kontrollorëve;
  - f) pezullimi ose përjashtimi i Anëtarëve (nëse është e aplikueshme);
  - g) miratimi i procesverbalit të Kuvendit paraardhës;
  - h) raporti i punës (që përmban aktivitetet që nga Kuvendit të fundit);
  - i) paraqitja e bilancit të konsoliduar dhe të rishikuar dhe të pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve;
  - j) miratimi i pasqyrave të audituara financiare;
  - k) miratimi i buxhetit;



- l) votimin për propozimet për ndryshime në këtë Statut, Rregulloren e Kuvendit dhe në Kodin Zgjedhor të FFK-së (nëse është e aplikueshme);
- m) diskutimi i propozimeve të paraqitura nga Anëtarët e Kuvendit dhe Komiteti Ekzekutiv në përputhje me procedurën e parashikuar sipas Nenit 33 paragrafi 3 të këtij Statuti;
- n) emërimi i auditorëve të pavarur dhe të jashtëm (nëse është e aplikueshme) me propozim të Komitetit Ekzekutiv;
- o) shkarkimi i një anëtari të një organi të FFK-së (nëse është e aplikueshme);
- p) zgjedhja e Presidentit dhe anëtarëve të mbetur të Komitetit Ekzekutiv;
- q) zgjedhja e anëtarëve të komisioneve të pavarura, d.m.th., Komisioni Mbikëqyrës, Komisioni Zgjedhor dhe Organet Gjyqësore (nëse ka) me propozim të Komitetit Ekzekutiv; dhe
- r) pranimi për anëtarësim.

3. Kuvendi nuk merr vendim për asnjë pikë që nuk është përfshirë në rendin e ditës.

4. Rendi i ditës i një Kuvendi të Rregullt mund të ndryshohet, me kusht që dy të tretat (2/3) e delegatëve që përfaqësojnë Anëtarët/ose Anëtarët e pranishëm në Kuvend dhe me të drejtë vote të jenë dakord për një mocion të tillë.

---

## Neni 35 Kuvendi i Jashtëzakonshëm

---

1. Komiteti Ekzekutiv mund të thërras Kuvend të Jashtëzakonshëm në çdo kohë. FIFA, UEFA dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve njoftohen nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Komiteti Ekzekutiv thërret Kuvend të Jashtëzakonshëm nëse më shumë se 50% të Anëtarëve të Kuvendit e bëjnë një kërkesë të tillë me shkrim ose nëse më shumë se 50% e pozicioneve të Komitetit Ekzekutiv bëhen të lira. Në kërkesë specifikohen pikat që duhet të përfshihen në rendin e ditës. Kuvend i Jashtëzakonshëm mbahet brenda tridhjetë (30) ditë nga marrja e kërkesës dhe plotësimit të kushteve tjera. Nëse Kuvendi i Jashtëzakonshëm nuk thirret nga Komiteti Ekzekutiv, atëherë delegatët e Kuvendit që e kanë kërkuar atë, mund ta thërrasin vetë Kuvendin. Duke vepruar kështu, ata informojnë të gjithë Anëtarët dhe Komitetin Ekzekutiv për datën dhe vendin e mbajtjes së Kuvendit të Jashtëzakonshëm, së bashku me pikat që do të përfshihen në rendin e ditës në përputhje me paragrafin 3 më poshtë.

3 Anëtarët njoftohen për vendin, datën dhe përmbledhjen e rendit të ditës së paku njëzet e pesë (25) ditë para datës së Kuvendit të Jashtëzakonshëm. Thirrja formale bëhet me shkrim së paku shtatë (7) ditë para datës së Kuvendit të Jashtëzakonshëm. Kjo thirrje përmban rendin e ditës dhe çdo dokument tjetër përkatës duke përfshirë edhe listën e kandidatëve zyrtarë (nëse është e nevojshme).

4. Kur thirret një Kuvend i Jashtëzakonshëm me iniciativën e Komitetit Ekzekutiv, ai duhet të hartojë rendin e ditës. Kur thirret me kërkesë të Anëtarëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga ata Anëtarë dhe mund të plotësohet nga Komiteti Ekzekutiv.

5. Rendi i ditës i një Kuvendi të Jashtëzakonshëm nuk mund të ndryshohet.

---

**Neni 36** Ndryshimet në Statut, Rregulloren e Kuvendit dhe në Kodin Zgjedhor

---

1. Kuvendi është përgjegjës për ndryshimin e këtij Statuti, Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin Zgjedhor të FFK-së.
2. Çdo propozim për ndryshim të këtij Statuti, Rregullores së Kuvendit dhe Kodit Zgjedhor të FFK-së duhet të dorëzohet me shkrim në Sekretariatit e Përgjithshëm, me një shpjegim të shkurtër nga Anëtarët ose nga Komiteti Ekzekutiv. Një propozim i paraqitur nga Anëtarët është i vlefshëm, me kusht që të jetë mbështetur me shkrim dhe të plotësohen kushtet për thirrjen e kuvendit.
3. Propozimi për ndryshim të këtij Statuti miratohet vetëm nëse dy të tretat (2/3) e delegatëve që përfaqësojnë Anëtarët të pranishëm dhe me të drejtë vote, votojnë në favor të ndryshimeve të propozuara.

---

**Neni 37** Procesverbalit

---

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për caktimin e një procesmbajtësi, për mbajtjen e procesverbalit në Kuvend.
2. Anëtarët e caktuar për të verifikuar procesverbalet duhet ta bëjnë këtë në mënyrë që procesverbalet t'u dërgohen Anëtarëve brenda tridhjetë (30) ditëve nga Kuvendi. Procesverbalit do të konsiderohet i aprovuar nëse nënshkruhet nga kryesuesi, procesmbajtësi dhe verifikuesi/it e procesverbalit, ndërsa nëse brenda dhjetë (10) ditëve nga dërgimi i tij paraqiten kundërshtime të arsyetuara me shkrim në Sekretariatit e Përgjithshëm atëherë kundërshtimet e tilla të procesverbalit vendosen për shqyrtim në rendin e ditës të Kuvendit të Zakonshëm pasardhës.

---

**Neni 38** Datat e hyrjes në fuqi të vendimeve

---

Vendimet e miratuara nga Kuvendi hyjnë në fuqi menjëherë pas mbylljes së Kuvendit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut ose nëse Kuvendi cakton një datë tjetër për hyrjen në fuqi të një vendimi.

## B. KOMITETI EKZEKUTIV

---

### Neni 39 Përbërja

---

1. Komiteti Ekzekutiv përbëhet deri në trembëdhjetë (13) anëtarë, duhet të ketë së paku një femër, dhe përbëhet si më poshtë:

a) Presidenti;

b) shtatë (7) anëtarë të Komitetit Ekzekutiv që përfaqësojnë interesat Lidhjet Rajonale të Futbollit dhe propozuar nga secila LRF nga një anëtar;

c) tre (3) anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të propozuar nga Presidenti; dhe

d) anëtarë të Komitetit Ekzekutiv që përfaqësojnë interesat e Anëtarëve të tjerë.

2. Komitetit Ekzekutiv zgjedh zëvendës-presidentin e parë dhe zëvendës-presidentin e dytë; Presidenti shprehë propozimet e tij. Kjo zgjedhje bëhet gjatë mbledhjes së parë pasi Presidenti dhe anëtarët e mbetur të Komitetit Ekzekutiv të zgjedhen nga Kuvendi në përputhje me nenin 32 të këtij Statuti. Të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv i nënshtrohen kontrollit të përshtatshmërisë dhe të integritetit, që do të bëhet nga Komisioni Zgjedhor, përpara zgjedhjes ose rizgjedhjes së tyre.

3. Mandati i Presidentit dhe i anëtarëve të mbetur të Komitetit Ekzekutiv është katër (4) vjet. Mandati i tyre ndjekë të njëjtin cikël zgjedhor. Mandati i tyre fillon menjëherë pas përfundimit të Kuvendit që i ka zgjedhur dhe skadon në fund të Kuvendit në të cilin zgjedhen pasardhësit e tyre. Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv (përfshirë Presidentin) nuk mund të shërbejnë më shumë se tre mandate (qoftë të njëpasnjëshme apo jo). Çdo mandat i pjesshëm llogaritet si një mandat i plotë.

4. Të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv i përmbushin parakushtet e përcaktuara në Nenin 25 paragrafi 8 të këtij Statuti.

5. Një anëtar i Komitetit Ekzekutiv nuk mund të jetë në të njëjtën kohë anëtar i një komisioni të pavarur dhe nuk mund të emërohet/zgjedhet si delegat në Kuvend (duke përjashtuar Presidentin).

6. Nëse një post (duke përfshirë Presidentin) ose deri në 50% e pozitave të Komitetit Ekzekutiv mbeten të zbrazëta, Komiteti Ekzekutiv i plotëson postin/et në fjalë deri në vendimin e Kuvendit të ardhshëm, kur zgjedhen zëvendësuesit e postit/eve për periudhën e mbetur të mandateve.

7. Nëse më shumë se 50% të pozicioneve të Komitetit Ekzekutiv janë të zbrazëta, anëtarët e mbetur të Komitetit Ekzekutiv thërrasin një Kuvend të Jashtëzakonshëm pasi që paraprakisht janë bërë zgjedhjet/propozimet nga lidhjet rajonale (për delegatët e propozuar nga ta), menjëherë brenda periudhës së parashikuar kohore. Në ndërkohë, anëtarët e mbetur të Komitetit Ekzekutiv përkujdesen për punët e përditshme të FFK-së deri në mbajtjen e zgjedhjeve të reja.

8. Çdo pozitë brenda Komitetit Ekzekutiv konsiderohet e zbrazët në rast vdekjeje, dorëheqjeje ose nëse anëtarë në fjalë pengohet përgjithmonë apo nuk mund të kryejë funksionin e tij zyrtar.

---

**Neni 40** Mbledhjet

---

1. Komitetit Ekzekutiv mblidhet të paktën gjashtë (6) herë në vit. Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv mund të mbahen me prezencë fizike, me video-konferenca ose në ndonjë format të përzier.
2. Presidenti thërret mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv. Nëse shumica (më shumë se 50%) e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv kërkojnë mbledhje, Presidenti e thërret atë në mënyrë që mbledhja të mbahet brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i kërkesës. Nëse Presidenti nuk e thërret mbledhjen e kërkuar brenda afatit të sipërpërmendur, anëtarët e tjerë të Komitetit Ekzekutiv e thërresin vetë, por duhet t'ua dërgojnë rendin e ditës të gjithë anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të paktën dy (2) ditë para mbledhjes, në përputhje me paragrafin 3 më poshtë.
3. Presidenti, i ndihmuar nga Sekretariati i Përgjithshëm, e përpilon rendin e ditës, i cili duhet t'u njoftohet anëtarëve së paku tre (3) ditë para mbledhjes. Secili anëtar i Komitetit Ekzekutiv ka të drejtë të propozojë pika për përfshirje në rendin e ditës. Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv duhet t'i dorëzojnë Sekretariatit të Përgjithshëm pikat që dëshirojnë të përfshihen në rendin e ditës të mbledhjes së paku dy (2) ditë para mbledhjes. Si rregull, rendi i ditës përfundimtar dhe dokumentet përkatëse duhet t'u dërgohen anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv së paku një (1) ditë para mbledhjes.
4. Sekretari i Përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv në rol konsultativ dhe pa të drejtë vote. Nëse Sekretari i Përgjithshëm nuk është në gjendje të marrë pjesë në një mbledhje, ai mund të emërojë një përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhje në emër të tij.
5. Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv nuk mbahen publikisht. Megjithatë, Komitetit Ekzekutiv mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë vote dhe mund të shprehin mendime vetëm me lejen e Komitetit Ekzekutiv.
6. Presidenti gjithashtu mund të thërrasë Komitetin Ekzekutiv në mënyrë urgjente për të trajtuar çështje që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme ndërmjet dy mbledhjeve të Komitetit Ekzekutiv. Në raste të tilla, afatet e përmendura në paragrafin 3 më sipër, ose mund të shkurtohen ose të mos merren parasysh nëse urgjenca ashtu e kërkon.

---

**Neni 41** Kompetencat

---

1. Komitetit Ekzekutiv ka kompetencat si vijon:
  - a) marrja e vendimeve për të gjitha rastet që nuk i përkasin sferës së përgjegjësisë së Kuvendit ose që nuk u rezervohen organeve të tjera me ligj ose me këtë Statut;
  - b) të zgjedhë midis anëtarëve të vet zëvendës-presidentin e parë dhe të dytë;
  - c) të sigurojë zbatimin e këtij statuti dhe miratimin e vendimeve ekzekutive të kërkuara për zbatimin e tyre, përfshirë miratimin dhe nxjerrjen e Rregullores të FFK-së, rregulloret për organizimin e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të përkohshme ose rregulloreve të tjera përkatëse;
  - d) të administrojë dhe të drejtojë aktivitetet e FFK-së në përputhje me këtë Statut;
  - e) të përgatis dhe rishikoj buxhetin, duke përfshirë përdorimin e fondeve për shpenzime të papritura në buxhet që nuk tejkalojnë masën 10% të buxhetit vjetor të FFK-së, të miratuar në Kuvendin më të fundit;
  - f) emërojë zyrtarin e autorizuar për të menaxhuar dhe mbajtjen e llogarive;

- g) përgatitja, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, dhe thirrja e Kuvendit të Rregullt dhe të Jashtëzakonshëm;
- h) emërimi i kryesuesve dhe anëtarëve të komisioneve të përhershme;
- i) vendosja për krijimin e komisioneve ad hoc nëse është e nevojshme në çdo kohë;
- j) miratimi dhe nxjerrja e rregulloreve për organizimin e komisioneve të përhershme dhe ad hoc;
- k) të emërojë dhe shkarkojë Sekretarin e Përgjithshëm me propozim të Presidentit, dhe emërimin dhe shkarkimin e Zëvendës-Sekretarit të Përgjithshëm;
- l) t'i propozojë Kuvendit auditorët e pavarur dhe të jashtëm;
- m) emërimi i zëvendësuesve për pozitat e zbrazëta në komisionet e pavarura deri në Kuvendin e ardhshëm;
- n) miratimi dhe nxjerrja e rregulloreve që rregullojnë kushtet e pjesëmarrjes dhe organizimit të garave të organizuara nga FFK;
- o) emërimi dhe shkarkimi i trajnerëve të ekipeve përfaqësuese dhe të stafit tjetër teknik;
- p) të propozojë dhe caktojë përfaqësues të FFK-së për zgjedhje/emërim në organe të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare;
- q) miratimi dhe nxjerrja e Rregullores për Organizim të Brendshëm të FFK-së;
- r) shkarkimi dhe/ose pezullimi i anëtarëve të një organi (përfshirë një anëtar të Komitetit Ekzekutiv), me ose pezullimi i një Anëtar të FFK-së përkohësisht, deri në një vendim tjetër të Kuvendit;
- s) delegimi i detyrave nën autoritetin e vet tek organet tjera; dhe
- t) emërimi i vëzhguesve të cilët mund të marrin pjesë në Kuvend pa të drejtë për të debatuar ose për të votuar.

---

## Neni 42 Vendimet

---

1. Komiteti Ekzekutiv konsiderohet i thirrur në mënyrë të rregullt nëse janë të pranishëm më shumë se 50% e anëtarëve të tij. Pjesëmarrja me video-konferencë konsiderohet prezencë.
2. Komiteti Ekzekutiv merr vendime me shumicë (më shumë se 50%) të votave të vlefshme, përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Statut. Nuk lejohet votimi me autorizim ose me letër. Kur një mbledhje e Komitetit Ekzekutiv mbahet me video-konferencë, lejohet votimi në internet (online) ose përmes mjeteve të tjera bashkëkohore të komunikimit me shkrim (p.sh. email, aplikacione mesazhesh).
3. Çdo anëtar i Komitetit Ekzekutiv duhet të tërhiqet nga debati dhe nga marrja e një vendimi nëse ekziston ndonjë rrezik ose mundësi për konflikt interesi.
4. Vendimet e marra shënohen në procesverbal dhe nënshkruhen nga kryesuesi dhe procesmbajtësi.
5. Vendimet e marra nga Komiteti Ekzekutiv hyjnë në fuqi menjëherë, përveç rasteve kur Komiteti Ekzekutiv vendos ndryshe.

## C. PRESIDENTI

---

### Neni 43 Presidenti

---

1. Presidenti është përgjegjës kryesisht për:
    - a) sigurimin që objektivi statutor, misioni, drejtimi strategjik, politikat dhe vlerat e FFK-së të ndiqen në mënyrë të qëndrueshme dhe nxitjen e një imazhi pozitiv të FFK-së;
    - b) zbatimin e vendimeve të nxjerra nga Kuvendi dhe Komiteti Ekzekutiv përmes Sekretariatit të Përgjithshëm dhe organeve tjera të FFK-së;
    - c) sigurimin e funksionimit efektiv të organeve për arritjen e objektivave të përshkruara në këtë Statut;
  - Z) mbikëqyrjen e punës së Sekretariatit të Përgjithshëm;
  - e) marrëdhëniet ndërmjet FFK-së dhe anëtarëve të saj, FIFA-së, UEFA-së, organeve politike dhe organizatave të tjera;
  - f) thirrjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komitetit Ekzekutiv.
2. Vetëm Presidenti mund t'i propozojë Komitetit Ekzekutiv emërimin dhe shkarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Trajnerëve të Shoqatave Kombëtare me personelin të tyre teknik.
  3. Presidenti kryeson mbledhjet e Kuvendit dhe të Komitetit Ekzekutiv dhe të atyre komisioneve në të cilat ai është emëruar kryesues. Presidenti mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm.
  4. Presidenti ka votë të rregullt në Komitetin Ekzekutiv. Në rast të barazimit të votave, votën përfundimtare e ka Presidenti.
  5. Nëse Presidenti mungon ose nuk është në dispozicion, nënpresidenti i parë në dispozicion e zëvendëson. Nëse nënpresidenti i parë mungon ose nuk është në dispozicion, nënpresidenti tjetër në dispozicion e zëvendëson.
  6. Nëse posti i Presidentit mbetet i zbrazët në kuptimin e nenit 39 par. 8 të këtij Statuti, nënpresidenti i parë e zëvendëson deri në Kuvendin e ardhshëm. Ky Kuvend zgjedh një President të ri për periudhën e mbetur të mandatit.
  7. Çdo kompetencë shtesë e Presidentit përfshihet në Rregulloren e Kuvendit.

---

### Neni 44 Përfaqësimi dhe nënshkrimi

---

Presidenti përfaqëson FFK-në në përgjithësi. Komiteti Ekzekutiv miraton dispozita të veçanta në Rregulloren e Kuvendit të FFK-së dhe rregullore tjera në lidhje me nënshkrimin e përbashkët të bartësve të posteve.

## D. SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM

---

### Neni 45 Sekretariati i përgjithshëm

---

Sekretariati i Përgjithshëm është organ operacional dhe administrativ i cili është nën mbikëqyrjen e Komitetit Ekzekutiv dhe kryen punët e FFK-së nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm. Anëtarët e sekretariatit të përgjithshëm respektojnë Rregulloren për organizimin e brendshëm ose rregullore tjera përkatëse të FFK-së dhe përbushin detyrat e përcaktuara në mirëbesim.

---

### Neni 46 Sekretari i Përgjithshëm

---

1. Sekretari i Përgjithshëm është udhëheqës organizativ i FFK-së.
2. Sekretari i Përgjithshëm emërohet me vendim të Komitetit Ekzekutiv, me propozim të Presidentit, dhe ka kualifikimet dhe/ose përvojën e nevojshme profesionale.
3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për:
  - a) zbatimin dhe/apo delegimin e vendimeve të nxjerra nga Kuvendi dhe Komiteti Ekzekutiv në përputhje me direktivat e Presidentit;
  - b) pjesëmarrje pa të drejtë vote në mbledhjet e Kuvendit dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe të komisioneve të përhershme dhe ad hoc;
  - c) së bashku me Komitetin Ekzekutiv bën organizimin e Kuvendit dhe mbledhjeve të organeve të tjera;
  - d) cakton procesmbajtësin për mbledhjet e Kuvendit, Komitetit Ekzekutiv dhe komisioneve të përhershme dhe ad hoc;
  - e) nën drejtimin e Komitetit Ekzekutiv, Sekretari i Përgjithshëm ose ndonjë zyrtar tjetër i autorizuar, bën menaxhimin dhe mbajtjen e llogarive;
  - f) korrespondencën;
  - g) nën drejtimin e Presidentit, mban marrëdhënie me Anëtarët, komisionet, FIFA-në dhe UEFA-në;
  - h) organizimin e sekretariatit të përgjithshëm;
  - i) nën drejtimin e Presidentit, Sekretari i Përgjithshëm ose ndonjë zyrtar tjetër i autorizuar bën emërimin dhe shkarkimin e personelit që punon në sekretariatit të përgjithshëm;
  - j) ofrimin e mbështetjes logjistike dhe operative për Komitetin Ekzekutiv për zgjedhjet.
4. Me pëlqimin e Komitetit Ekzekutiv, Sekretari i Përgjithshëm mund të emërojë Zëvendës-Sekretarin e Përgjithshëm për të kryer një ose më shumë nga kompetencat e mësipërme. Çdo përgjegjësi dhe detyrë shtesë që i caktohet Sekretarit të Përgjithshëm apo Zëvendës-Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohet në Rregulloren për organizimin e brendshëm të FFK-së.
5. Sekretari i Përgjithshëm nuk është delegat i Kuvendit ose anëtar i ndonjë organi tjetër.

6. Komiteti Ekzekutiv me vendim vendos për kushtet dhe detajet e tjera për postin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe të Zëvendës-Sekretarit të Përgjithshëm.

## E. KOMISIONET E PËRHERSHME

---

### Neni 47 Komisionet e përhershme

---

1. Komisionet e përhershme janë:

- a) Komisioni i Financave;
- b) Komisioni Organizativ për Ligat dhe Garat e FFK-së;
- c) Komisioni i Statusit të Lojtarëve;
- d) Komisioni i Amatorëve, Fillestarëve (grassroots), Futsal dhe Mini-Futboll;
- e) Komisioni Teknik dhe Zhvillimor;
- f) Komisioni i Referëve;
- g) Komisioni për Futbollin e Femrave;
- h) Komisioni i Akteve Ligjore dhe Normative; dhe
- i) Komisioni i Infrastrukturës dhe Projekteve;

2. Kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të përhershme mund të jenë anëtarë të Komitetit Ekzekutiv, me përjashtim të atyre të Komisionit të Referëve, të cilët nuk mund të jenë pjesë e Komitetit Ekzekutiv.

3. Anëtarët e secilit komision të përhershëm emërohen nga Komiteti Ekzekutiv me propozimin e Anëtarëve të FFK-së ose të Presidentit. Kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të përhershme caktohen për një mandat deri katër (4) vitesh. Ata mund të emërohen ose shkarkohen nga Komiteti Ekzekutiv në çdo kohë, pa miratimin e Kuvendit.

4. Anëtarët e komisionit të përhershëm duhet të kenë të gjitha kapacitetet, njohuritë, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve të tyre përkatëse. Komiteti Ekzekutiv siguron përfaqësimin e duhur të femrave dhe të palëve të interesuara në komisionet e përhershme.

5. Secili kryetar përfaqëson komisionin e tij të përhershëm dhe zhvillon punë në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores së Organizimit të Brendshëm të FFK-së, të miratuar nga Komiteti Ekzekutiv.

6. Çdo kryetar cakton datat e takimeve në bashkëpunim me Sekretariatit të Përgjithshëm, siguron që të gjitha detyrat janë kryer dhe i raporton Komitetit Ekzekutiv. Takimet mund të zhvillohen me prezencë fizike ose me video-konferencë.

7. Komiteti Ekzekutiv dhe çdo komision i përhershëm, ky i fundit me miratimin e Komitetit Ekzekutiv, mundet, nëse është e nevojshme, të krijojë një byro dhe/ose nën-komision për zgjidhjen e çështjeve urgjente; në një rast të tillë, vendimet mund të kalohen përmes mjeteve moderne të komunikimit me shkrim (p.sh. email, aplikacione mesazhesh). Çdo diskutim dhe vendim i byrosë dhe/ose nën-komisionit i raportohet komisionit të përhershëm përkatës sa më shpejt që të jetë e mundur të bëhet një gjë e tillë.

8. Secili komision i përhershëm mund t'i propozojë Komitetit Ekzekutiv ndryshime në dispozitat përkatëse të Rregullores për organizimin e brendshëm të FFK-së, që kanë të bëjnë me komisionin e tij.

9. Komisionet e përhershme nuk kanë kompetencë vendimmarrëse, përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Statut ose në rregulloren përkatëse të organizimit të brendshëm të FFK-së.



---

**Neni 48** **Komisioni i Financave**

---

Komisioni i Financave monitoron menaxhimin financiar dhe këshillon Komitetin Ekzekutiv për çështje financiare dhe menaxhimin e asetëve. Analizon buxhetin dhe pasqyrat financiare të përgatitura nga njerëzit e financave përmes Sekretarit të Përgjithshëm dhe ia paraqet ato Komitetit Ekzekutiv për miratim. Ai përbëhet nga një kryetar dhe së paku dy (2) anëtarë.

---

**Neni 49** **Komisioni Organizativ i Garave dhe i Ligave (kategorive) të FFK-së**

---

Komisioni Organizativ i Garave të FFK-së organizon garat e FFK-së në futboll, futsal dhe të tjera në çdo nivel brenda territorit të Republikës së Kosovës në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe rregulloret e zbatueshme për garat e FFK-së. Komisioni përbëhet nga një kryetar dhe së paku dy (2) anëtarë.

---

**Neni 50** **Komisioni Teknik dhe Zhvillimor**

---

Komisioni Teknik dhe Zhvillimor analizon në radhë të parë aspektet themelore të trajnimit në futboll dhe zhvillimit teknik në futboll. Ai është gjithashtu përgjegjës për programet e zhvillimit të FFK-së, hartimin dhe propozimin e strategjive të përshtatshme, monitorimin e këtyre strategjive dhe analizimin e mbështetjes dhe programeve të ofruara për Anëtarët e FFK-së dhe ofrimin e këshillave për Komitetin Ekzekutiv rreth çështjeve teknike dhe të zhvillimit në përgjithësi. Ai përbëhet nga një kryetar dhe së paku (2) anëtarë.

---

**Neni 51** **Komisioni i Referëve**

---

Komisioni i Referëve zbaton Ligjet e Lojës si dhe Ligjet e Lojës në Futsall dhe të Futbollit në Rërë. Ai cakton gjyqtarët dhe ndihmësit e tyre për ndeshjet në garat e organizuara nga FFK, organizon çështjet e referimit në kuadër të FFK-së, në bashkëpunim me administratën dhe monitoron edukimin dhe trajnimin e referëve. Ai përbëhet nga një kryetar dhe së paku (2) anëtarë, të cilët duhet të jenë ish-referë.

---

**Neni 52**    **Komisioni i Futbollit të Femrave**

---

Komisioni i Futbollit të Femrave organizon garat e futbollit të femrave dhe merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me futbollin e femrave. Komisioni përbëhet nga një kryetar dhe së paku dy (2) anëtarë.

---

**Neni 53**    **Komisioni i Statusit të Lojtarëve**

---

1. Komisioni i Statusit të Lojtarëve krijon dhe monitoron pajtueshmërinë me rregulloret e transferimeve në përputhje me Rregulloren e FIFA-së për Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve dhe përcakton statusin e lojtarëve për garat e ndryshme të FFK-së. Komiteti Ekzekutiv mund të miratojë rregullore të veçanta që rregullojnë kompetencat e juridiksionit të Komisionit të Statusit të Lojtarëve. Komisioni i Statusit të Lojtarëve përbëhet nga një kryetar dhe së paku (2) anëtarë.

2. Mosmarrëveshjet e statusit të lojtarëve që përfshijnë FFK-në, Anëtarët e saj, klubet, lojtarët, zyrtarët, agjentët dhe agjentët e licencuar të ndeshjeve, zgjidhen në shkallën e fundit nga një tribunal arbitrazhi e pavarur dhe e formuar në mënyrë të rregullt në përputhje me këtë Statut dhe i nënshtrohet ligjeve nacionale të zbatueshëm.

---

**Neni 54**    **Komisioni i amatorëve, i fillestarëve (grassroots), Futsalit, Mini-Futbollit dhe Futbollit në Rërë**

---

1. Komisioni i amatorëve, i fillestarëve (grassroots), Futsalit, Mini-Futbollit dhe Futbollit në Rërë merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me amatorët dhe fillestarët (grassroots) në kuadër të FFK-së dhe të Anëtarëve të saj. Komisioni i amatorëve, i fillestarëve (grassroots), Futsalit, Mini-Futbollit dhe Futbollit në Rërë mbikëqyr programet për zhvillimin dhe rritjen e futbollit në hapësira të mbyllura, mini-futbollit, futbollit në rërë (plazh) ose kategorive të tjera të futbollit me synim popullarizimin e këtyre kategorive dhe ngritjen e nivelit të përfaqësimit në garat nacionale dhe ndërkombëtare.

2. Komisioni i amatorëve, i fillestarëve (grassroots), Futsalit, Mini-Futbollit dhe Futbollit në Rërë përbëhet nga një kryetar dhe dy dhe së paku dy (2) anëtarë.

---

**Neni 55**    **Komisioni i Akteve Ligjore dhe Normative**

---

1. Komisioni i Akteve Ligjore dhe Normative mbikëqyr pajtueshmërinë me Statutin dhe rregulloret e FFK-së përmes përditësimit të normave ligjore në përputhje me standardet e FIFA-së dhe/ose UEFA-së. Mbikëqyrë cilësinë e vendimmarrjes së organeve drejtuese të FFK-së dhe i raporton Komitetit Ekzekutiv për veprimtarinë e tyre.

2. Komisioni i Akteve Ligjore dhe Normative ka të drejtë të ofrojë interpretim ligjor për çështje të ndryshme juridike të kërkuara nga organet e FFK-së. Komisioni i Akteve Ligjore dhe Normative përbëhet nga një kryetar dhe së paku dy (2) anëtarë të cilët duhet të kenë përvojë juridike.

---

**Neni 56**    **Komisioni i Infrastrukturës dhe Projekteve**

---

Komisioni i Infrastrukturës dhe Projekteve mbikëqyrë veprimtarinë e strukturave të Sekretariatit të Përgjithshëm lidhur me zhvillimin e infrastrukturës sportive në Kosovë dhe administrimin e projekteve të FFK-së. Komisioni përbëhet nga një kryetar dhe së paku dy (2) anëtarë.

---

**Neni 57**    **Komisionet Ad hoc**

---

Komiteti Ekzekutiv, nëse është e nevojshme, mund të krijojë komisione ad hoc për detyra të veçanta dhe për një periudhë të kufizuar kohore. Komiteti Ekzekutiv emëron një kryetar dhe një numër të duhur të anëtarëve. Detyrat dhe funksionet e komisioneve ad hoc përcaktohen në rregullore të veçanta të miratuara nga Komiteti Ekzekutiv. Një komision ad hoc i raporton drejtpërdrejt Komitetit Ekzekutiv.

## F. ORGANET E LICENCIMIT TË KLUBEVE

---

### Neni 58 Organet e licencimit të klubeve

---

1. Organet licencuese të klubeve janë përgjegjëse për sistemin e licencimit të klubeve në kuadër të FFK-së, në përputhje me Rregulloret e Licencimit të Klubeve të FFK-së dhe UEFA-së.
2. Organet licencuese të klubeve përbëhen nga një organ i shkallës së parë dhe një organ apeli.
3. Vendimet e marra nga organi i apelimit për licencimin e klubeve mund të apelojnë vetëm pranë CAS në përputhje me dispozitat në këtë Statut.

### Neni 59 Pavarësia institucionale

---

1. Komisionet e pavarura si dhe anëtarët e tyre individualë kryejnë aktivitetet dhe detyrat e tyre tërësisht në mënyrë të pavarur, por gjithmonë në interes të FFK-së dhe në përputhje me Statutin dhe rregulloret e saj.
2. Kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të pavarura zgjedhen nga Kuvendi me propozim të Komitetit Ekzekutiv dhe mund të lirohen nga detyra vetëm nga Kuvendi me propozim nga Komiteti. Ata nuk janë anëtarë të asnjë organi tjetër të FFK-së.
3. Mandati i të gjithë anëtarëve të komisioneve të pavarura zgjat deri në katër (4) vjet. Ata mund të rizgjedhen.
4. Kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës, të Komisionit Zgjedhor dhe të Organeve Gjyqësore respektojnë kriteret e pavarësisë të përcaktuara në paragrafin 5 më poshtë.
5. Personat e përmendur në paragrafin 4 më lart, si dhe anëtarët e afërt të familjeve të tyre nuk mund të ushtrorjnë ose të kenë ushtruar gjatë katër (4) viteve para fillimit të funksionit të tyre, asnjë funksion ekzekutiv në FFK, në kuadër të njërit prej Anëtarëve, të një Lige apo të një Klubi (duke përfshirë kompanitë/organizatat e tyre të lidhura), as nuk mund të kenë apo të kenë pasur për katër (4) vjet përpara fillimit të mandatit të tyre ndonjë marrëdhënie materiale biznesi me FFK-në, një nga anëtarët, një ligë apo një klub (përfshirë kompanitë/organizatat e lidhura). “Anëtar i afërt i familjes” në lidhje me një person nënkupton bashkëshortin ose partnerin e zakonshëm të atij personi, vëllezërit e motrat, prindërit, gjyshërit, xhaxhallarët, hallat, fëmijët (përfshirë fëmijët e bashkëshortit/tes ose fëmijët e birësuar), kunetërit, kunatat, vjehri ose vjehrra, dhe përfshin këdo tjetër, qofshin lidhje gjaku ose jo, me të cilët individ ka marrëdhënie të ngjashme me marrëdhënie familjare për të cilën personi në fjalë ofron mbështetje financiare.
6. Kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të pavarura (me përjashtim të Komisionit Zgjedhor) i nënshtrohen kontrollit të përshtatshmërisë dhe integritetit, i cili kryhet nga Komisioni Zgjedhor në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe të Kodit Zgjedhor të FFK-së, para zgjedhjes ose rizgjedhjes së tyre.

---

### Neni 60 Komisioni Mbikëqyrës

---

1. Komisioni Mbikëqyrës mbikëqyrë dhe monitoron FFK-në, mbikëqyrë zbatimin e akteve të FFK-se, siguron plotësinë dhe besueshmërinë e kontabilitetit financiar (d.m.th. bilancin e konsoliduar dhe të rishikuar dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjes) dhe shqyrton pasqyrat financiare vjetore të audituara, duke përfshirë pasqyrën financiare të konsoliduar dhe raportet e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm. Komisioni Mbikëqyrës, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, zbaton një program përputhshmërie brenda FFK-së.
2. Komisioni Mbikëqyrës përbëhet nga një kryetar dhe së paku dy (2) anëtarë dhe funksioni i Komisionit Zgjedhor rregullohen me këtë Statut dhe rregullorën përkatëse.
3. Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës kanë njohuri dhe përvojë në çështjet financiare ose rregullative dhe ligjore dhe nuk mund të përfshihen në asnjë vendim që ndikon në funksionimin e FFK-së.

4. Komiteti Ekzekutiv, organet tjera të FFK-së dhe Sekretariati i Përgjithshëm bashkëpunojnë me Komisionin Mbikëqyrës gjatë kryerjes së detyrave të tij. Komisioni Mbikëqyrës mund t'u sugjerojë organeve përkatëse çdo veprim që e gjykon të nevojshëm si rezultat i një monitorimi të tillë.

5. Komisioni Mbikëqyrës për punën e tij i raporton Kuvendit të FFK-së dhe Komitetit Ekzekutiv. Mënyra dhe modalitetet e punës së Komisionit Mbikëqyrës mund të përcaktohen edhe me Rregulloren e Komisionit Mbikëqyrës.

---

## Neni 61 Komisioni zgjedhor

---

1. Komisioni Zgjedhor është organi përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në pajtim me Kodin Zgjedhor të FFK-së.

2. Përbërja dhe funksioni i Komisionit Zgjedhor rregullohet me këtë Statut dhe me Kodin Zgjedhor të FFK-së.

3. Vendimet e nxjerra nga Komisioni Zgjedhor janë përfundimtare dhe mund të referohen vetëm në CAS në përputhje me dispozitat në këtë Statut.

---

## Neni 62 Organet gjyqësore

---

1. Organet gjyqësore janë:

- a) Komisioni Disiplinor dhe i Etikës;
- b) Komisioni i Ankesave; dhe
- c) Inspektorët Disiplinorë.

2. Organet gjyqësore duhet të përbëhen në atë mënyrë që anëtarët, së bashku, të kenë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e nevojshme të specializuar për kryerjen e duhur të detyrave dhe punëve të tyre. Kryetarët duhet të jenë të kualifikuar si jurist dhe të kenë më shumë se pesë (5) vite përvojë profesionale.

3. Anëtarët tjerë të Organeve Gjyqësore duhet të jenë të kualifikuar si juristë dhe të kenë më shumë se tri (3) vite përvojë profesionale.

4. Nëse kryetari, zëvendëskryetari ose një anëtar i një organi gjyqësor pushon së kryeri funksionin e tij zyrtar gjatë mandatit të tij, Komiteti Ekzekutiv cakton një zëvendësues për të shërbyer deri në vendimin e radhës të Kuvendit, në të cilin, Kuvendi cakton një anëtar të ri të organit gjyqësor përkatës për periudhën e mbetur.

5. Përgjegjësitë dhe funksioni i organeve gjyqësore përcaktohen në aktin përkatës të FFK-së (rregullore, kod, varësisht cila zbatohet).

---

## Neni 63 Komisioni Disiplinor dhe i Etikës

---

1. Komisioni Disiplinor dhe i Etikës përbëhet nga kryetari dhe numri i nevojshëm i anëtarëve të tjerë siç përcaktohet nga Komiteti Ekzekutiv.

2. Komisioni Disiplinor dhe i Etikës, si rregull, shqyrton çështjet në komision me tre (3) anëtarë, të emëruar nga kryetari rast pas rasti. Përfundimet mund të përcaktohen në Kodin Disiplinor dhe i Etikës të FFK-së, i cili mund të parashikojë që kryetari ose një anëtar që vepron si kryetar ad hoc, të shqyrtojë çështje të veçanta si gjyqtar i vetëm.

3. Funksioni i Komisionit Disiplinor dhe të Etikës rregullohet me Kodin Disiplinor dhe të Etikës të FFK-së.

4. Komisioni Disiplinor dhe i Etikës mund të shqyrtojë sanksionet e përshkruara në këtë Statut dhe në Kodin Disiplinor dhe të Etikës të FFK-së për Anëtarët, zyrtarët e Anëtarëve, zyrtarët e FFK-së, lojtarët, klubet, agjentët e licencuar të ndeshjeve dhe ndërmjetësuesit.

5. Këto dispozita nuk prekin kompetencat e Kuvendit dhe të Komitetit Ekzekutiv lidhur me pezullimin dhe përfundimin e Anëtarëve.

6. Komiteti Ekzekutiv nxjerr Kodin Disiplinor dhe të Etikës të FFK-së, i cili është në përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin Disiplinor të FIFA-së, UEFA-së dhe Kodin Etik të FIFA-së.

---

## Neni 64 Komisioni i Ankesave

---

1. Komisioni i Ankesave përbëhet nga kryetari dhe numri i nevojshëm i anëtarëve të tjerë të përcaktuar nga Komiteti Ekzekutiv.

2. Komisioni i Ankesave, si rregull, i shqyrton çështjet në një trup gjykues prej tre (3) anëtarësh, të caktuar nga kryetari rast pas rasti. Kodi Disiplinor dhe i Etikës i FFK-së mund të parasheh përfundime, të cilat mund të parashikojnë që kryetari ose anëtarë që vepron si kryetar ad hoc, të vendosë vetëm për ankesat të cilat janë të papranueshme, të bazuara ose të pabazuara.

3. Funksioni i Komisionit për Ankesa rregullohet me Kodin Disiplinor dhe të Etikës të FFK-së.

4. Komisioni i Ankesave është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor dhe të Etikës, të cilat nuk janë shpallur përfundimtare me rregulloret përkatëse të FFK-së.

5. Vendimet e shpallura nga Komisioni i Ankesave janë të formës së prerë dhe mund t'i referohen CAS ose një tribunali të pavarur dhe të formuar në mënyrë të rregullt, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

---

## Neni 65 Inspektorët Disiplinorë

---

1. Komiteti Ekzekutiv cakton numrin e nevojshëm të inspektorëve disiplinorë dhe cakton njërin prej tyre si kryeinspektor.

2. Inspektorët disiplinorë përfaqësojnë FFK-në në procedurat para Komisionit Disiplinor dhe të Etikës dhe Komisionit të Ankesave. Funksioni i inspektorëve disiplinorë rregullohet me Kodin Disiplinor dhe të Etikës të FFK-së.

**Neni 66**    **Masat disiplinore**

---

1. Masat disiplinore janë kryesisht:

1.1. për personat fizik dhe juridik:

- a) paralajmërim (vërejtje);
- b) qortim;
- c) gjobë;
- d) kthimi i çmimeve.

1.2. Për personat fizik:

- a) paralajmërim (vërejtje);
- b) përjashtim;
- c) pezullim i ndeshjes;
- d) ndalim nga dhomat e zhveshjes dhe/ose stoli i zëvendësuesve;
- e) ndalim hyrje në stadium;
- f) ndalim pjesëmarrje në aktivitet lidhur me futbollin;
- g) punë sociale;
- h) trajnim për pajtueshmërinë.

1.3. për persona juridik:

- a) ndalim transferimi;
- b) luajtja e ndeshjes pa shikues;
- c) luajtja e një ndeshje në territor neutral;
- d) ndalim për të luajtur në një stadium të caktuar;
- e) anulim i rezultatit të ndeshjes;
- f) përjashtim nga gara;
- g) humbje;
- h) heqje e pikëve;
- i) rënie në një kategori më të ulët;
- j) përsëritje e ndeshjes.



**Neni 67 Arbitrazi**

---

1. Mosmarrëveshjet brenda FFK-së ose mosmarrëveshjet që prekin anëtarët e FFK-së, ligat, anëtarët e ligave, klubet, anëtarët e klubeve, lojtarët dhe zyrtarët mund të referohen vetëm në shkallën e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha kanaleve të brendshme brenda FFK-së) në CAS ose një tribunal të arbitrazhit të pavarur dhe e formuar siç duhet e cila zgjidhë mosmarrëveshjen përfundimisht, me përjashtim të çdo gjykate të zakonshme.
2. Mosmarrëveshjet e dimensionit ndërkombëtar që rrjedhin ose lidhen me Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e UEFA-së dhe/ose FIFA-së, mund të dorëzohen vetëm në shkallën e fundit në CAS siç specifikohet në Statutin e UEFA-së dhe të FIFA-së.

---

**Neni 68 Juridiksioni**

---

1. FFK ka juridiksion për mosmarrëveshjet e brendshme nacionale, d.m.th. mosmarrëveshjet ndërmjet palëve që i përkasin ose ndërlidhen me FFK-në.
2. UEFA dhe/ose FIFA kanë juridiksion për mosmarrëveshjet ndërkombëtare, d.m.th. mosmarrëveshjet ndërmjet palëve që i përkasin shoqatave dhe/ose konfederatave të ndryshme, në përputhje me rregulloret përkatëse.
3. FFK siguron përputhjen e plotë të tij dhe të të gjithë atyre që i nënshtrohen juridiksionit të saj me çfarëdo vendimi të formës së prerë, të marrë nga një organ i FIFA-së, një organ i UEFA-së, nga një tribunal arbitrazhi, e njohur nga FFK ose CAS.

**Neni 69**    **Periudha financiare**

---

1. Periudha financiare e FFK-së është njëvjeçare dhe fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
  2. Të hyrat dhe shpenzimet e FFK-së menaxhohen në mënyrë që ato të balancohen gjatë periudhës financiare. Detyrat kryesore të FFK-së në të ardhmen garantoohen përmes krijimit të rezervave.
  3. Sekretari i Përgjithshëm dhe/ose departamenti financiar ose FFK-ja është përgjegjës për hartimin e llogarive vjetore të konsoliduara të FFK-së me filialet e saj më 31 dhjetor.
- 

**Neni 70**    **Të hyrat**

---

1. Të hyrat e FFK-së përfshijnë:
    - a) Abonimet vjetore të Anëtarëve;
    - b) faturat e krijuara nga tregtimi i të drejtave për të cilat FFK ka të drejtë;
    - c) gjobat e shqiptuara nga organet e autorizuara;
    - d) abonime dhe fatura të tjera në përputhje me objektivat e ndjekura nga FFK;
    - e) donacionet;
    - f) të ardhura të tjera të ndërlidhura me aktivitetet e futbollit;
    - g) financimi, donacionet, huatë dhe lloje tjera të financimit nga FIFA, UEFA, institucionet e Republikës së Kosovës dhe subjekte të tjera ligjore.
- 

**Neni 71**    **Shpenzimet**

---

1. FFK bart:
  - a) shpenzimet e parashikuara në buxhet;
  - b) shpenzime të tjera të miratuara nga Kuvendi dhe shpenzime që Komiteti Ekzekutiv ka të drejtë të kryejë brenda fushës së autoritetit të tij;
  - c) financimi, donacionet, huatë dhe llojet tjera të financimit nga FFK tek Anëtarët;
  - d) të gjitha shpenzimet e tjera në përputhje me objektivat e ndjekura nga FFK.

---

**Neni 72 Auditorët e pavarur dhe të jashtëm**

---

Auditorët e pavarur dhe të jashtëm të propozuar nga Komiteti Ekzekutiv dhe të emëruar nga Kuvendi kontrollojnë çdo vit llogaritë e miratuara nga Komiteti Ekzekutiv në përputhje me parimet e duhura të kontabilitetit dhe i paraqesin Kuvendit një raport. Auditorët e pavarur dhe të jashtëm emërohen për një periudhë prej një (1) vit. Mandati i tyre mund të vazhdohet.

---

**Neni 73 Abonimet e anëtarësisë**

---

1. Abonimet e anëtarësisë bëhen në baza vjetore, propozohen nga Komiteti Ekzekutiv dhe vendosen nga Kuvendi. Abonimi vjetor për anëtarët e rinj për vitin në fjalë paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga mbyllja e Kuvendit në të cilin ata janë pranuar.

2. Kuvendi me propozim të Komitetit Ekzekutiv e cakton shumën e parapagimit vjetor çdo dy (2) vjet, me rekomandimin e Komitetit Ekzekutiv. Ai do të jetë i njëjtë për çdo Anëtar dhe kap shumën jo më shumë se 200 (dyqind) Euro.

---

**Neni 74 Shlyerja**

---

FFK mund të debitojë asetet dhe llogaritë e çdo Anëtari për të shlyer pretendimet.

---

**Neni 75 Tarifat**

---

FFK mund të kërkojë që Anëtarët e saj të paguajnë tarifa për ndeshje.

---

**Neni 76 Publikimi i të dhënave financiare**

---

1. FFK publikon dokumentet financiare të referuara në Nenin 34 paragrafi 2 i), j) dhe k) të këtij Statuti në faqen e saj zyrtare të internetit, pasi pikat përkatëse të jenë miratuar nga Kuvendi.

2. Shpërblimi i anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv (përfshirë Presidentin), Sekretarit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura mund të vihen gjithashtu në dispozicion të publikut (p.sh. përmes faqes zyrtare të internetit të FFK-së) rregullisht ose në raporte vjetore.

**Neni 77**    **Garat**

---

1. FFK organizon dhe koordinon garat zyrtare të mëposhtme kryesore që zhvillohen brenda territorit të saj:

- a) Kampionati i Superligës;
- b) Kupa e Republikës së Kosovës;
- c) Superkupa e Republikës së Kosovës;
- d) Kampionati i Ligës së Parë (Grupi A dhe B apo një ligë unike)
- e) Kampionati i Ligës së Dytë;
- f) Kampionati i Superligës U 19;
- g) Kampionati i parë i Ligës U19;
- h) Kampionati i Superligës për Femra;
- i) Kampionati i Ligës së Parë - Femra;
- j) Kampionati i Ligës U 17 (Grupi A dhe B);
- k) Kampionati i Superligës së Futsallit;
- l) l) Kampionati i Ligës së Parë në Futsall; dhe
- m) Kampionati i Ligës së Veteranëve.

3. Komiteti Ekzekutiv mund t'u delegojë lidhjeve vartëse të FFK-së, autoritetin për të organizuar gara (d.m.th. me anë të një marrëveshjeje të rregullt dhe gjithëpërfshirëse). Garat e organizuara nga lidhjet nuk ndërhyjnë në garat që organizohen nga FFK. Garat e organizuara nga FFK kanë përparësi.

4. Komiteti Ekzekutiv mund të nxjerrë rregullore të veçanta për këtë qëllim.

---

**Neni 78**    **Licencimi i klubeve**

---

Komiteti Ekzekutiv nxjerr rregullore në lidhje me sistemin e licencimit të klubeve që rregullon pjesëmarrjen e klubeve në garat e FFK-së dhe UEFA-së, në përputhje me kërkesat minimale të sistemit të licencimit të klubeve, të përcaktuara nga FFK, UEFA dhe FIFA.

---

**Neni 79**    **Të drejtat**

---

1. FFK dhe Anëtarët e saj janë pronarët e parë të të gjitha të drejtave që rrjedhin nga garat dhe ngjarjet e tjera që janë nën juridiksionin e tyre përkatës, pa asnjë kufizim për sa i përket përmbajtjes, kohës dhe vendit. Këto

të drejta përfshijnë, ndër të tjera, çdo lloj të drejte financiare, të drejtat e regjistrimit audio-vizual dhe radiofonik, të riprodhimit dhe transmetimit, të drejtat multimediale, të drejtat e marketingut dhe promovimit dhe të drejta të patrajuara si emblemat dhe të drejtat që rrjedhin nga ligji për të drejtën e autorit.

2. Komiteti Ekzekutiv vendosë se si dhe në çfarë mase përdoren këto të drejta dhe harton rregullore të veçanta për këtë qëllim. FFK siguron që shitja e këtyre të drejtave të kryhet në mënyrë transparente dhe në përputhje me Statutin dhe rregulloret e FFK-së si dhe me ligjet nacionale të detyrueshme.

---

## Neni 80 Autorizimi për shpërndarje

---

1. FFK dhe Anëtarët e saj janë ekskluzivisht përgjegjës për autorizimin e shpërndarjes së imazhit dhe zërit dhe bartësve të tjerë të të dhënave të ndeshjeve dhe ngjarjeve të futbollit që janë nën juridiksionin e tyre përkatës, pa asnjë kufizim.

2. Komiteti Ekzekutiv nxjerrë rregullore të veçanta për këtë qëllim.

**Neni 81** Ndeshjet dhe garat ndërkombëtare

---

1. Autoriteti për organizimin e ndeshjeve dhe garave ndërkombëtare ndërmjet ekipeve përfaqësuese dhe ndërmjet ligave, ekipeve të klubeve dhe/ose ekipeve gërvishitëse i takon vetëm FIFA-së, UEFA-së dhe FFK-së. Asnjë ndeshje apo garë e tillë nuk zhvillohet pa lejen paraprake të FIFA-së, UEFA-së dhe FFK-së, në përputhje me Rregulloren e FIFA-së që Rregullon Ndeshjet Ndërkombëtare.

2. FFK është e lidhur me kalendarin ndërkombëtar të ndeshjeve të përpiluara nga FIFA.

---

**Neni 82** Kontaktet

---

FFK, Anëtarët e saj, lojtarët, zyrtarët, agjentët e licencuar të ndeshjeve dhe ndërmjetësit, nuk mund të luajnë ndeshje ose të bëjnë kontakte sportive me shoqatat që nuk janë anëtare të FIFA-së ose anëtarë të përkohshëm të një UEFA-së, pa miratimin e FIFA-së.

---

**Neni 83** Miratimi

---

1. Klubet, ligat ose çdo grup tjetër klubesh që janë të lidhur me FFK-në, mund t'i bashkohen një shoqate tjetër vetëm me autorizimin e FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së.

2. Klubet, ligat ose çdo grup tjetër klubesh që janë të lidhur me FFK-në nuk mund të marrin pjesë në gara në territorin e një shoqate tjetër pa autorizimin e FFK-së, FIFA-së dhe UEFA-së sipas Rregullores së FIFA-së që Rregullon Ndeshjet Ndërkombëtare dhe Rregullat e Autorizimit të UEFA-së që rregullojnë garat ndërkombëtare të klubeve.

**Neni 84 Raste të paparashikuara dhe forca madhore (force majeure)**

---

Komiteti Ekzekutiv ka kompetencën të vendosë për të gjitha rastet e forcës madhore dhe për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut; vendime të tilla marrin parasysh rregulloret përkatëse të FIFA-së dhe të UEFA-së si dhe çdo ligj të detyrueshëm të zbatueshëm.

---

**Neni 85 Publikimi i dokumenteve të FFK-së**

---

FFK-ja vë në dispozicion në faqen e saj zyrtare të internetit, dokumentet dhe informacionin e mëposhtëm:

- a) Statutin dhe Rregulloren e Përhershme të Kuvendit;
  - b) Kodin Zgjedhor;
  - c) Kodin Disiplinor dhe të Etikës;
  - d) Rregulloren e Organizimit të Brendshëm;
  - e) Vendimet më të rëndësishme/kyçe;
  - f) Strategjinë e vet;
  - g) Përmbledhje e rendin e ditës për mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe të Kuvendit; dhe
  - h) Qarkoret.
- 

**Neni 86 Shpërbërja**

---

1. Çdo vendim në lidhje me shpërbërjen e FFK-së kërkon një shumicë prej dy të tretave (2/3) të të gjithë Anëtarëve të FFK-së, e cila duhet të sigurohet në një Kuvend të thirrur posaçërisht për këtë qëllim.

2. Nëse FFK shpërbëhet, asetet e saj do t'i transferohen një shoqate tjetër me qëllime dhe aktivitete të ngjashme si FFK-ja. Ajo do t'i mbajë këto pasuri si administrues i besuar në përputhje me detyrat përkatëse profesionale deri në rithemelimin e FFK-së. Kuvendi përfundimtar, megjithatë, mund të zgjedhë një marrës tjetër për asetet në bazë të shumicës prej dy të tretave (2/3) të të gjithë Anëtarëve të FFK-së.

---

**Neni 87 Zbatimi**

---

Ky Statut u miratua në Kuvend në Selinë e FFK-së në Prishtinë më 27.01.2023 dhe hyn në fuqi më 27.01.2023. Statuti i mëparshëm i FFK-së me këtë rast, shfuqizohet.

---

## Neni 88 Dispozitat kalimtare

---

1. Anëtarëve, të përcaktuar në Nenin 13 paragrafi 2 të këtij Statuti, do t'u jepet një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh që nga miratimi i këtij Statuti, për t'iu përmbajtur kërkesave të detyrueshme të përcaktuara në Nenin 14 si dhe Nenin 17 të këtij Statuti. Çdo Anëtar i cili nuk i plotëson të gjitha këto kërkesa brenda afatit kohor të lartpërmendur, automatikisht humbë të drejtën e votës në Kuvend dhe delegati(ët) e Anëtarit në fjalë nuk merren parasysh gjatë vendosjes së kuorumit. Anëtari në fjalë rifiton të drejtën e tij të votës në Kuvend vetëm pasi të ketë përmbushur plotësisht detyrimet e tij të përmendura në këtë paragraf.
2. Pavarësisht nga Neni 87 më lart, të gjitha aktet e brendshme të FFK-së mbeten në fuqi deri në ndryshimin e tyre, gjë që duhet të bëhet brenda një (1) viti nga data e miratimit të këtij Statuti.
3. Pavarësisht nga Neni 87 më lart, Neni 39 paragrafi 1 i këtij Statuti hyn në fuqi nga Kuvendi Zgjedhor i FFK-së i vitit 2026.
4. Mandati i Presidentit të FFK-së të zgjedhur në Kuvendin Zgjedhor të FFK-së të vitit 2022 të mbajtur më 6 prill 2022 dhe i anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të zgjedhur në Kuvendin Zgjedhor të FFK-së të vitit 2020 të mbajtur më 27 janar 2020, përfundon me zgjedhjen e pasardhësve të tyre në Kuvendin Zgjedhor të FFK-së në vitin 2026. Mandatet e mbajtura para Kuvendit Zgjedhor të FFK-së në vitin 2026 nuk merren parasysh për qëllim të kufizimeve të mandatit të përcaktuara në Nenin 39 paragrafi 3 të këtij Statuti.
5. Pas miratimit të këtij Statuti, anëtarët e komisioneve të përhershme të përcaktuara në Nenet 47 deri në 57 të këtij Statuti, të cilët janë tashmë në fuqi, mbesin në vend deri në përfundimin e mandatit të tyre përkatës. Për më tepër, çdo pozitë shtesë në komisionet e përhershme që ende duhet të plotësohen me miratimin e këtij Statuti, plotësohen brenda një periudhe 12 mujore duke filluar nga miratimi i këtij Statuti dhe deri në përfundimin e mandatit të komisionit të përhershëm, dhe në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.
6. Pas miratimit të këtij Statuti, anëtarët e komisioneve të pavarura, të përcaktuara në nenet 60 deri në 65 të këtij Statuti, që janë tashmë në fuqi, qëndrojnë në funksion deri në përfundimin e mandatit të tyre përkatës. Për më tepër, çdo pozitë shtesë në komisionet e pavarura që ende duhet të plotësohen me miratimin e këtij Statuti, plotësohen brenda një periudhe 12 mujore duke filluar nga miratimi i këtij Statuti dhe në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.
7. Me përjashtim të nenit 39 paragrafit 2 dhe nenit 59 paragrafit 6 të këtij Statuti, kërkesa për t'iu nënshtuar kontrollit të përshtatshmërisë dhe integritetit nuk zbatohet për anëtarët e Komitetit Ekzekutiv, duke përfshirë Presidentin e FFK-së dhe anëtarët e komisioneve të pavarura të cilët janë në funksion në momentin e miratimit të këtij Statuti, por respektohen nga cilido kandidat për pozitë në Komitetin Ekzekutiv, përfshirë Presidentin e FFK-së dhe anëtarët e komisioneve të pavarura, pas miratimit të këtij Statuti.

Prishtinë më, 27.01.2023;

Për Federatën e Futbollit të Kosovës

Agim Ademi  
Presidenti

Taulant Hodaj  
Sekretari i Përgjithshëm



### **Pjesa 1: Dispozitat e përgjithshme**

---

1. Kontrollat e përshtatshmërisë dhe integritetit lidhur me kandidatët dhe mbajtësit e pozitave zyrtare brenda FFK-së që i nënshtrohen kontrolleve të tilla ("kandidatët ose mbajtësit") kryhen nga organi përkatës në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe këtij aneksi.

2. Kandidatët ose mbajtësit janë të detyruar të pajtohen me procesin e shqyrtimit dhe vetë-zbulimit siç përshkruhet në pjesët 2 dhe 3 më poshtë. Përpara procesit të shqyrtimit, çdo kandidat ose mbajtës jep pëlqimin me shkrim për këtë proces nëpërmjet një formulari të ofruar nga organi përkatës që kryen kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit. Nëse nuk jepet një pëlqim i tillë me shkrim, kandidati ose mbajtësi konsiderohet se nuk e ka kaluar kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit.

3. Kandidatët ose mbajtësit veprojnë me mirëbesim në çdo kohë dhe bashkëpunojnë plotësisht, për të vërtetuar faktet përkatëse pas njoftimit të arsyeshëm. Nëse kandidati ose mbajtësi në fjalë nuk bashkëpunon me organin kompetent për të kryer kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit, kandidati ose mbajtësi konsiderohet se nuk e ka kaluar kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit.

4. Kandidati ose mbajtësi konsiderohet se nuk e ka kaluar kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit, nëse ai:

a) ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në Kapitullin XXXIII të Kodit Penal të Kosovës që kanë të bëjnë me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrave zyrtare, si dhe të mos jenë dënuar për kurdisje të ndeshjeve nga organet e FIFA-së, UEFA-së apo FFK-së;

b) është shpallur fajtor, dënuar apo suspenduar nga Komisioni i Etikës i FIFA-së, UEFA ose Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i FFK-së ose ndonjë organ sportiv me një sanksion që do të vinte seriozisht në pikëpyetje shkarkimin e detyrës në fjalë.

5. Duke iu nënshtruar dispozitave përkatëse në lidhje me zbulimin dhe përcjelljen e informacionit dhe të të dhënave përkatëse, të marra në kontekstin e kontrolleve të përshtatshmërisë dhe integritetit në përputhje me këtë aneks, të gjitha këto informacione dhe të dhëna të ndërlidhura, duhet të trajtohen si rreptësisht konfidenciale nga organi që kryen kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit në fjalë.

---

### **Pjesa 2: Procesi i shqyrtimit**

---

1. Në fillim të procesit të shqyrtimit, çdo kandidat ose mbajtës i nënshtrohet një kontrolli identifikimi ("kontrolli ID"). Në këtë kuadër, kandidati ose mbajtësi i dorëzojnë organit përgjegjës për kryerjen e kontrollit të përshtatshmërisë dhe integritetit. Kontrolli i Identitetit përfshin verifikimin/identifikimin e elementeve të mëposhtëm:

- a) emrin/at dhe mbiemrin/at;
- b) adresën e banimit;
- c) datën dhe vendin e lindjes;

d) nacionalitetin/nacionalitetet.

2. Çdo kandidat ose mbajtës plotëson pyetësin e përfshirë në pjesën 3 më poshtë.

3. Organi përgjegjës për kryerjen e kontrollit të përshtatshmërisë dhe integritetit mund të kryejë kërkime dhe/ose hetime të pavarura për të marrë informacione të mëtejshme përkatëse për një kandidat ose mbajtës të caktuar, i cili mund të përfshijë informacion mbi ndërmjetësit dhe palët e ndërlidhura, mandatet, konfliktet e mundshme të interesit dhe pjesëmarrjet e rëndësishme si dhe procedurat/hetimet civile dhe penale.

---

### Pjesa 3: Pyetësi

---

Emri:	
Mbiemri:	
Adresa e banimit:	
Data dhe vendi i lindjes:	
Nacionaliteti/nacionalitetet:	
Profesioni:	

1. A keni qenë më parë i dënuar me vendim të formës së prerë për veprat penale të përcaktuara në Kapitullin XXXIII të Kodit Penal të Kosovës që kanë të bëjnë me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrave zyrtare ose ndonjë shkelje që korrespondon me një shkelje të rregullave të sjelljes të përcaktuara në Pjesën II neni 5 të Kodit të Etikës të FIFA-së?

       
Jo      Po

Nëse po, ju lutem specifikoni:

2. A ka vendosur ndonjëherë një organ drejtues sportiv ndaj jush ndonjë sanksion ose masë disiplinore ose të ngjashme në të kaluarën, për veprime që përbëjnë shkelje të rregullave të sjelljes të përcaktuara në Pjesën II neni 5 të Kodit të Etikës të FIFA-së?

       
Jo      Jo

Nëse po, ju lutem specifikoni:

3. A i jeni nënshtruar ndonjë procedure ose hetimi civil, penal ose disiplinor që është në pritje?

Jo

Po

Nëse po, ju lutem specifikoni:

4. Jam plotësisht i vetëdijshëm se iu nënshtrohem dispozitave të Kodit Disiplinor dhe të Etikës të FFK-së dhe dispozitave të Statutit dhe rregulloreve të tjera të FFK-së që mund të trajtojnë çështjet e integritetit, dhe plotësisht i përmbahem dispozitave të tilla.
5. Aktualisht mbaj këto pozita në futboll:
6. Faktet dhe rrethanat e mëposhtme mund të shkaktojnë konflikte të mundshme interesi në lidhje me mua (shih në veçanti nenin 25 paragrafi 9 të këtij Statuti):
7. Vërejtje dhe vështrime të cilat mund të jenë të rëndësishme në kontekstin e kontrollit të përshtatshmërisë dhe integritetit:
8. Jam plotësisht i vetëdijshëm dhe pajtohem që ky pyetësor të vihet në dispozicion të anëtarëve të organit përkatës të FFK-së.
9. Jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj se duhet të njoftoj organin që kryen kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit për çdo fakt dhe rrethanë të rëndësishme që lind pas përfundimit të kontrollit të integritetit.
10. Jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj se jam i detyruar të bashkëpunoj plotësisht për të vërtetuar faktet përkatëse në lidhje me kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit të cilit i nënshtrohem. Në veçanti, unë do të përmbush kërkesat për çdo dokument, informacion ose çdo material tjetër të çfarëdo natyre të mbajtur nga unë. Për më tepër, unë do t'i përmbahem sigurimit dhe ofrimit të dokumenteve, informacioneve ose çdo materiali tjetër të çfarëdo natyre që nuk mbahet nga unë, por që kam të drejtë t'i marrë.
11. Jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj se organi që kryen kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit mund të kërkojë gjithashtu informacion mbi sanksionet e mundshme (pyetjet 1 dhe 2 më lart) drejtpërdrejt nga FIFA ose konfederata përkatëse si dhe nga institucione të tjera si Gjykata e Arbitrazhit Sportiv në Lozanë, Zvicër, ose Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. Në këtë drejtim, unë liroj institucionet përkatëse nga çdo detyrim konfidencialiteti në lidhje me informacionin në fjalë.
12. Jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj se organi që kryen kontrollin e përshtatshmërisë dhe integritetit mund të mbledhë informacione të mëtejshme për mua në përputhje me Pjesën 2 paragrafin 3 të këtij aneksi.

Prishtinë më, 27.01.2023;

Për Federatën e Futbollit të Kosovës

Agim Ademi  
Presidenti

Taulant Hodaj  
Sekretari i Përgjithshëm